LIGJ
Nr.10 448, datë 14.7.2011

PËR LEJET E MJEDISIT*

(Ndryshuar me ligjin nr. 44/2013, datë 14.2.2013; nr. 60/2014, datë 19.6.2014; nr. 52/2020, datë 30.4.2020; nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës.

Neni 2
Objekti

Ky ligj përcakton:

a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;

b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë.

Neni 3
Përkufizime

(shtuar fjalë në pikën 13, shfuqizuar pika 14 nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

***** Ky ligj është përafruar plotësisht me këto direktiva: Direktiva 2008/1/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 15 janarit 2008 "Mbi kontrollin dhe parandalimin e integruar të ndotjes", e ndryshuar, numri CELX: 32008L0001, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.24, datë 29.1.2008, f. 8-29.
Direktiva 2001/80/KE e Parlamentit Europian dhe e Këshillit e 23 tetorit 2001 "Mbi kufizimin e shkarkimeve të disa ndotësve në ajër nga instalimet e mëdha me djegie", numri CELEX: 32001L0080, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Europian, seria L, nr.309, datë 27.11.2001, f. 1-21.

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Autoriteti përkatës i qeverisjes vendore" është njësia e qeverisjes vendore në territorin e së cilës është vendosur instalimi.

2. "Agjencia Kombëtare e Mjedisit" ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

3. "Agjencia rajonale e mjedisit" është njësia rajonale përkatëse e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit.

4. "Depozitim gjeologjik i CO_2" është injektimi i shoqëruar me depozitimin e rrymave (flukseve) të CO_2 në formacione gjeologjike nëntokësore.

5. "Ditë" është një ditë pune, sipas përcaktimit të dhënë nga Kodi i Punës.

6. "Formacion gjeologjik" është nënndarja litostratigrafike, brenda së cilës mund të gjenden dhe hartëzohen shtresa shkëmbore të caktuara.

7. "Gjendje e pranueshme e mjedisit" është gjendja në të cilën mjedisi i vendit në fjalë ishte para se instalimi të vihej në operim. Arritja e kësaj gjendjeje kërkon masa që përfshijnë, por nuk kufizohen me: largimin e të gjitha mbetjeve që kanë tepruar, largimin sa më shumë të jetë e mundur të çdo lloj ndotjeje, dhe, aty ku ky largim nuk do të thotë trajtim praktik apo stabilizim i ndotjes, rehabilitimin e çdo dëmi që mund të ketë shkaktuar ndotja, si dhe zbutjen e efekteve të çdo dëmi.

8. "Instalim" është çdo njësi teknike e palëvizshme, që kryen një ose shumë veprimtari, si dhe çdo lloj tjetër veprimtarie që lidhet drejtpërdrejt me të apo ka një lidhje teknike me veprimtaritë e zhvilluara në njësinë e mësipërme dhe që mund të ndikojë në shkarkimet dhe ndotjen;

9. "Instalim ekzistues" është:

a) një instalim që është në funksionim në datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji;

b) një instalim që nuk është vënë ende në funksionim në datën kur ky ligj hyn në fuqi, por për të cilin është dhënë leja e ndërtimit, sipas përcaktimit të ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", dhe ndërtimi i të cilit fillon brenda një viti nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

10. "Instalim i ri" është:

a) një instalim që nuk është instalim ekzistues;

b) një instalim ekzistues, për funksionimin e të cilit operatori nuk ka kërkuar pajisjen me lejen përkatëse të mjedisit, brenda periudhës kohore të përcaktuar në këtë ligj. Në këtë rast, ky instalim trajtohet si një instalim i ri.

11. "Inspektorati Shtetëror Kompetent" është autoriteti inspektues, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

12. "Leje mjedisi e tipit A" është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/A, e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, të lëshuar nga QKB-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit A, sipas përcaktimit të këtij ligji, dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

13. "Leje mjedisi e tipit B" është leja për veprimtaritë e përcaktuara në aneksin 1/B e përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe e firmosur nga ministri, e cila lëshohet nga QKB-ja, që i jep të drejtën e funksionimit, tërësisht ose pjesërisht, instalimit të tipit B, sipas përcaktimit të këtij ligji dhe që përmban të shkruara kushtet e nevojshme për të garantuar se instalimi përmbush kërkesat e këtij ligji dhe të legjislacionit në fuqi. Një leje mund të mbulojë një ose më shumë instalime ose pjesë të instalimeve në të njëjtën vendndodhje dhe që operohen nga një i njëjti operator.

14. Shfuqizuar.

15. “Mjedis” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

16. “Ministër” është ministri përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit.

17. “Ministria” është ministria përgjegjëse për mbrojtjen e mjedisit.

18. “Mbetje të rrezikshme”, “Mbetje jo të rrezikshme”, “Mbetje inerte”, “Mbetje urbane” dhe “Lendfill” kanë kuptimin e dhënë në legjislacionin e posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

19. “Muaj” është një muaj kalendarik.

20. “Ndotje” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

21. “Ndryshim funksionimi”, në lidhje me instalimin, është një ndryshim në natyrën e funksionimit ose një zgjerim i instalimit, që mund të ketë pasoja në mjedis.

22. “Ndryshim i konsiderueshëm”, në lidhje me instalimin, është një ndryshim në funksionimin e tij, i cili, në vlerësimin e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, mund të ketë një efekt negativ të konsiderueshëm mbi njeriun dhe mjedisin. Çdo ndryshim apo zgjerim i veprimtarisë vlerësohet si i konsiderueshëm, në qoftë se ndryshimi apo zgjerimi prek pragjet përcaktuese të vendosura në këtë ligj, për instalimet e tipit A ose B.

23. “Normat e cilësisë së mjedisit” është një grup kushtesh që duhen përmbushur në një kohë të dhënë nga një mjedis i caktuar ose një pjesë e veçantë e tij, sipas përcaktimit të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

24. “Normat teknike të shkarkimit në mjedis” janë vlerat teknike kufi të shkarkimit, që lidhen me teknologjinë e prodhimit, makineritë dhe pajisjet në përdorim, sipas përcaktimit të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

25. “Operator” është personi fizik apo juridik që operon ose kontrollon instalimin, apo të cilit i është deleguar fuqi ekonomike vendimtare për funksionet teknike të instalimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Si operator i një instalimi, që:

a) nuk është vënë ende në funksionim, konsiderohet personi që do të kontrollojë funksionimin e tij në të ardhmen;

b) nuk funksionon më, konsiderohet personi të cilit i ishte dhënë leje mjedisi për funksionimin e këtij instalimi.

26. “Publik” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

27. “Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB)” është institucioni përkatës, sipas përcaktimit të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”.

28. “Rrymë CO_2” është një fluks substancash që rezultojnë nga proceset e kapjes së CO_2.

29. “Substancë” është çdo element kimik dhe përbërjet e tij, me përjashtim të substancave radioaktive dhe të organizmave të modifikuar gjenetikisht, sipas përcaktimit të dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

30. “Shkarkim” ka kuptimin e dhënë në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”.

31. “Shkarkim në ujë” janë shkarkimet në trupat ujorë, ku përfshihen shkarkimet në rrjetin e tubacioneve të ujërave të zeza e të bardha.

32. “Teknikat më të mira të disponueshme (TMD)” është stadi më efektiv dhe më i përparuar i zhvillimit të veprimtarive dhe të metodave të operimit të tyre. Ky stad tregon se sa të përshtatshme janë praktikisht teknikat e veçanta për të siguruar, në parim, bazën për të përcaktuar vlera kufi të shkarkimeve, të tilla që të parandalojnë dhe, kur nuk është praktikisht e mundshme, të pakësojnë shkarkimet në përgjithësi dhe ndikimin mbi mjedisin në tërësi.

Për qëllime të këtij përkufizimi, me termat e mëposhtëm kuptojmë:

a) “Teknikë” është teknologjia dhe mënyra me të cilën instalimi është projektuar, ndërtuar, mirëmbajtur dhe çmontuar;

b) “Teknikë e disponueshme” janë teknikat e zhvilluara në atë nivel që mundëson përdorimin e tyre, në sektorin përkatës industrial, me rezultate të mira ekonomike e teknike. Vlerësimi i teknikave

merr parasysh kostot dhe përparësitë, pavarësisht nga fakti nëse ato teknika përdoren apo prodhohen në Republikën e Shqipërisë, për sa kohë ato janë të arritshme nga përdoruesi;

c) "Më e mirë", në lidhje me teknikat, është teknika më efektive për arritjen e një niveli të lartë të përgjithshëm të mbrojtjes së mjedisit në tërësi.

33. "Vend depozitimi për CO_2" është një hapësirë vëllimore në një formacion gjeologjik, që përdoret për depozitimin gjeologjik të CO_2 dhe të pajisjeve të sipërfaqes e të injektimit, që përdoren për këtë qëllim.

34. "Vlera kufi e shkarkimit" është masa e shprehur në disa parametra specifikë, përqendrimet dhe/ose nivelet e shkarkimeve që nuk mund të tejkalohen në një ose më shumë periudha kohore.

35. "Biomasë" është produkt i përbërë, tërësisht ose pjesërisht, nga material bimor nga bujqësia ose pemëtaria, që mund të përdoret si lëndë djegëse, me qëllim rikuperimin e energjisë së përmbajtur në të, përfshirë mbetjet e mëposhtme, të përdorura si lëndë djegëse:

a) mbetje vegjetale nga bujqësia dhe pyjet;

b) mbetje vegjetale nga industria e përpunimit të ushqimeve, në qoftë se prej tyre mund të çlirohet nxehtësi;

c) mbetje vegjetale fijezore nga prodhimi i masës së celulozës dhe nga prodhimi i letrës nga druri, në qoftë se digjen bashkërisht në vendin e prodhimit dhe rikuperohet nxehtësia e çliruar;

ç) mbetje nga lëvoret e pemëve;

d) mbetje drusore, me përjashtim të mbetjeve drusore që mund të përmbajnë përbërës organikë të halogjenuar ose metale të rënda, si rezultat i trajtimit me ruajtës ose me shtresa ruajtëse të drurit, dhe që përfshin në mënyrë të veçantë mbetjet drusore të krijuara nga mbetjet e ndërtimeve e të shembjeve.

36. "Impiant me djegie" është çdo aparaturë teknike, ku oksidohen lëndë djegëse, në mënyrë që të përdoret nxehtësia e gjeneruar.

37. "Impiantet e reja me djegie" është çdo instalim me djegie, për të cilin leja e ndërtimit apo e përdorimit të veprimtarisë, sipas ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", është dhënë pas datës së miratimit të këtij ligji.

38. "Impiantet ekzistuese me djegie" është çdo instalim me djegie, për të cilin leja e ndërtimit apo e përdorimit të veprimtarisë, sipas ligjit nr.10 119, datë 23.4.2009 "Për planifikimin e territorit", është dhënë para datës së miratimit të këtij ligji.

39. "Lëndë djegëse" është çdo material i djegshëm, i ngurtë, i lëngshëm apo i gaztë, i përdorur në instalimin me djegie, me përjashtim të mbetjeve, sipas përcaktimit të legjislacionit të posaçëm për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

40. "Mbetje të gazta" janë shkarkime të gazta, që përmbajnë substanca të ngurta, të lëngshme ose të gazta; fluksi vëllimor i tyre do të shprehet në m^3/orë, në temperaturën standard (273°K) dhe presion (101,3 kPa) pas korrigjimit të përmbajtjes së avullit të ujit, (më poshtë referuar si Nm^3/h).

41. "Njësi djegieje me shumë lëndë djegëse" është çdo impiant djegieje, ku mund të digjen njëkohësisht ose në mënyrë të alternuar dy a më shumë lloje lëndësh djegëse.

42. "Përqindja e desulfurizimit" është përqindja e sasisë së squfurit që nuk shkarkohet në ajër, në instalimin me djegie, për një periudhë të dhënë kohe ndaj sasisë së squfurit në përmbajtjen e karburantit, të përdorur gjatë së njëjtës periudhë kohe, në këtë instalim.

43. "Turbinë me gaz" është çdo makineri rrotulluese që shndërron energjinë termike në punë mekanike dhe përbëhet kryesisht nga një kompresor, një njësi termike ku oksidohet lënda djegëse, në mënyrë që të ngrohë masën e lëngshme të punës, dhe një turbinë.

44. "Vlera kufi e shkarkimit" është sasia e lejueshme e një substance në masën e gaztë të shkarkuar në ajër nga instalimi me djegie, gjatë një periudhe të dhënë. Sasia e substancës llogaritet në terma të masës/për vëllim të gazeve të shkarkuara, të shprehura në mg/Nm^3, duke konsideruar një përmbajtje vëllimore oksigjeni në gazet e shkarkuara: prej 3 për qind, në rastin e karburanteve të

lëngshme e të gazta, 6 për qind në rastin e karburanteve të ngurta dhe 15 për qind në rastin e turbinave me gaz.

Neni 4

Sistemi i lejeve të mjedisit

(ndryshuar paragrafi i parë i pikës 1 , shfuqizuar shkronja "c" e pikës 1, shfuqizuar shkronja "ç" e pikës 2, ndryshuar pika 3 me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

1 Në përputhje me ligjin nr. 10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", krijohet një sistem prej dy nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipave A e B, si më poshtë:

a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij ligji;

b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;

c) shfuqizuar.

2. Autoritetet kompetente për lejet e mjedisit të tipave A dhe B janë si më poshtë:

a) Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) është autoriteti ku bëhet kërkesa dhe ku lëshohet leja e mjedisit të tipit A dhe B;

b) Ministri është autoriteti që firmos aktin e miratimit të lejeve të mjedisit të tipit A dhe B, pasi ato të shqyrtohen dhe përgatiten nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit;

c) Agjencia Kombëtare e Mjedisit është autoriteti që verifikon saktësinë e informacionit të dhënë nga operatori në kërkesën e tij për leje mjedisi të tipit A dhe B dhe që i jep mendimin e argumentuar ministrit për dhënien ose jo të kësaj lejeje, me kushte të detajuara, të shkruara, të cilat lëshohen nga QKB-ja;

ç) shfuqizuar;

d) Inspektorati Shtetëror Kompetent është autoriteti që verifikon plotësimin nga operatori të kushteve të kësaj lejeje, pas lëshimit të saj nga QKB-ja.

3. Lista e veprimtarive të përfshira dhe kushtet e lejes së mjedisit të tipave A dhe B rishikohen në çdo kohë nga ministria kur ka ndryshime në legjislacionin përkatës mjedisor, të cilit ato i përmbahen dhe në raste kur konstatohen nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, nëse:

a) evidentohet ekzistenca e veprimtarive të reja që kanë ndikim në mjedis;

b) shfaqen elemente të reja ekologjike, të panjohura në kohën e dhënies së saj;

c) dalin dispozita të reja për mjedisin, që e kërkojnë shprehimisht ndryshimin e saj;

ç) vërtetohet ndotje tej normave të lejuara;

d) ka ndryshime themelore të veprimtarisë;

dh) ka përparime në fushën e teknikave më të mira të mundshme, që lejojnë pakësimin e rëndësishëm të shkarkimeve në mjedis dhe që nuk kërkojnë shpenzime të mëdha.

KREU II
LEJET E MJEDISIT TË TIPIT A

Seksioni 1
Procedura dhe metoda për përcaktimin e TMD-ve

Neni 5

Përcaktimi i TMD-ve

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton TMD-të, për instalimet e kategorisë së tipit A, duke u mbështetur në:

a) përdorimin e teknologjisë që shkarkon pak mbetje;

b) përdorimin e substancave më pak të rrezikshme;

c) rikuperimin dhe riciklimin e mëtejshëm të substancave të përdorura dhe të çliruara nga proceset e punës, aty ku është e mundur;

ç) rikuperimin dhe riciklimin e mbetjeve, aty ku është e mundur;

d) procese, instalime ose metoda pune të krahasueshme me ato që janë provuar më parë me sukses në shkallë industriale;

dh) përparimet e teknologjisë dhe ndryshimet në njohuritë shkencore dhe kuptimin e tyre;

e) llojin, natyrën, efektet dhe vëllimin e shkarkimeve;

ë) datën e vënies në funksionim të instalimeve të reja dhe atyre ekzistuese;

f) kohën e nevojshme për zbatimin e TMD-ve;

g) llojin, natyrën dhe konsumin e lëndëve të para, përfshirë edhe konsumin e ujit të përdorur dhe efiçencën e energjisë;

gj) efiçencën e energjisë;

h) nevojën për të parandaluar ose, kur kjo nuk është e mundur, për të ulur në minimum, ndikimet e përgjithshme dhe rreziqet e shkarkimeve në mjedis;

i) nevojën për të parandaluar aksidentet ose, kur këto ndodhin, për të minimizuar pasojat në mjedis;

j) çdo informacion të publikuar nga Komisioni Europian dhe organizatat ndërkombëtare për TMD-të, së bashku me monitorimin dhe çdo përditësim të tyre.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, gjatë përcaktimit të TMD-ve, në përputhje me sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, merr në konsideratë:

a) kostot dhe përfitimet e një veprimi dhe/ose mase të parashikuar;

b) respektimin e objektivave të mbrojtjes së mjedisit, të përcaktuara në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit";

c) respektimin e parimeve të politikës për mbrojtjen e mjedisit, të përcaktuara në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Neni 6

Dokumentet e referencës për TMD-të

1. Përcaktimi i TMD-ve, në përputhje me nenin 5 të këtij ligji, mbështetet në:

a) dokumentet e referencës së TMD-ve, të përgatitura nga grupet teknike të punës;

b) dokumentet e referencës së TMD-ve, të përgatitura nga Komisioni Europian (EU-BREF);

c) praktikën më të mirë ndërkombëtare.

2. Ministri ngre grupet teknike të punës, me qëllim zhvillimin e dokumenteve të referencës së TMD-ve, sipas përcaktimit të shkronjës "a" të pikës 1 të këtij neni dhe përcakton mënyrën e funksionimit të tyre.

3. Grupet teknike të punës, sipas përcaktimit të pikës 2 të këtij neni, përbëhen nga përfaqësues të:

a) ministrisë;

b) Agjencisë Kombëtare të Mjedisit;

c) Inspektoratit Shtetëror Kompetent;

ç) ministrive të tjera dhe sektorëve në varësi të tyre, kur sfera e tyre e kompetencave lidhet drejtpërdrejt me çështjen e trajtuar;

d) universiteteve ose institucioneve të tjera kërkimore, fusha e kërkimit e të cilëve lidhet drejtpërdrejt me çështjen e trajtuar;

dh) organizatave joqeveritare, fusha e veprimit e të cilave lidhet drejtpërdrejt me çështjen e trajtuar.

4. Çdo dokument reference i TMD-ve, i përgatitur nga një grup teknik pune, sipas pikës 2 të këtij neni, miratohet nga ministri.

5. Çdo dokument reference i TMD-ve, i miratuar sipas përcaktimit të pikës 4 të këtij neni, publikohet në mënyrë elektronike.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit ngre dhe mirëmban sistemin e informacionit për dokumentet e referuara në pikën 1 të këtij neni. Sistemi i informacionit publikohet në mënyrë elektronike në faqen e saj zyrtare të internetit dhe është i hapur për publikun.

Neni 7

Zhvillimi i TMD-ve të reja

Ministria dhe Agjencia Kombëtare e Mjedisit marrin dhe përditësojnë informacionin për zhvillimin e TMD-ve të reja.

Seksioni 2

Lejet e mjedisit të tipit A

Neni 8

Kërkesat e përgjithshme për përdorimin e lejes së mjedisit të tipit A

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë A pajisen me leje mjedisi të tipit A, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. E njëjta leje mjedisi e tipit A mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipit A dhe B, sipas rastit.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk përgatit lejen e mjedisit të tipit A, kur provon mbi baza objektive se:

a) pas zotërimit të asaj lejeje, kërkuesi nuk do të jetë operator i instalimit në fjalë;

b) kërkuesi nuk do të sigurojë funksionimin e instalimit, në përputhje me kushtet që do të përcaktohen në lejen përkatëse të mjedisit të tipit A.

Për qëllime të këtij paragrafi, merret në konsideratë edhe historia e deriatëhershme e këtij kërkuesi të lejes dhe/ose historia e deriatëhershme e instalimit.

Neni 9

Parimet e përgjithshme që përcaktojnë detyrimet thelbësore të zotëruesit të lejes së mjedisit të tipit A

Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton kushtet për lejet e mjedisit të tipit A, të tilla që të garantojnë se:

a) janë marrë të gjitha masat e duhura parandaluese të ndotjes, në mënyrë të posaçme përmes zbatimit të TMD-ve;

b) nuk shkaktohet ndotje në nivel të lartë;

c) gjenerimi i mbetjeve është parandaluar në përputhje me legjislacionin e posaçëm për

menaxhimin e integruar të mbetjeve. Aty ku gjenerohen mbetje, ato ripërdoren ose kur kjo është teknikisht dhe ekonomikisht e pamundur, ato trajtohen duke parandaluar ose zbutur çdo ndikim në mjedis;

ç) energjia përdoret në mënyre efiçente;

d) uji përdoret në mënyrë efiçente;

dh) janë marrë masa të posaçme për të parandaluar aksidentet ose për të kufizuar pasojat e tyre;

e) në mbylljen përfundimtare të veprimtarisë, merren masat e nevojshme për të mënjanuar rreziqet e ndotjes dhe për të kthyer mjedisin e vendit ku ndodhet instalimi në gjendje të pranueshme, siç përcaktohet në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Neni 10

Kërkesa për leje mjedisi të tipave A dhe B

1. Kërkesat për leje mjedisi të tipit A dhe B paraqiten në QKB, në përputhje me kërkesat e përgjithshme, sipas përcaktimit të dispozitave të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

2. QKB-ja e vlerëson kërkesën për leje mjedisi të tipit A dhe B si të vlefshme, vetëm kur kërkuesi ka kryer ose provon që ka kryer pagesën e tarifës përkatëse, siç përcaktohet në nenin 26 të këtij ligji. Kërkesa për leje mjedisi të tipit A dhe B nuk vlerësohet e kryer, në qoftë se ajo nuk shoqërohet nga dokumenti që vërteton kryerjen e pagesës së tarifës përkatëse.

Neni 11

Shqyrtimi i kërkesës për leje mjedisi të tipave A dhe B

Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit, miraton kërkesat e posaçme për shqyrtimin e kërkesave për leje mjedisi të tipave A dhe B, për transferimin e lejeve nga një subjekt tek tjetri, kushtet e lejeve respektive të mjedisit, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet kompetente, të përcaktuara në këtë ligj, deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja.

Seksioni 3

Kërkesa shtesë për impiantet e mëdha me djegie

Neni 12

Fusha e zbatimit të seksionit 3

1. Ky seksion zbatohet për impiantet me djegie, fuqia termike e të cilave është e barabartë ose më e madhe se 50 MW, pavarësisht nga lloji i karburantit të përdorur (i ngurtë, i lëngshëm ose i gaztë), në përputhje me përcaktimin e pikës 2 të këtij neni.

2. Ky seksion zbatohet vetëm për impiantet me djegie, të projektuara për prodhimin e energjisë, me përjashtim të atyre që përdorin në mënyrë të drejtpërdrejtë produktet e djegies në procesin e prodhimit. Ky seksion nuk zbatohet për:

a) impiantet në të cilat produktet e djegies përdoren për ngrohjen, tharjen ose çdo lloj tjetër trajtimi të drejtpërdrejtë të objekteve ose materialeve, si p.sh., rinxehjen e furrnaltave, furrnaltat për trajtime me nxehtësi;

b) impiantet pas djegies, të tilla si aparaturat teknike të projektuara për të pastruar gazrat e mbetura nëpërmjet djegies, të cilat nuk funksionojnë si një impiant me djegie, i pavarur;

c) impiantet për rigjenerimin e katalizatorëve të krekingut katalitik;

ç) impiantet për konvertimin e sulfurit të hidrogjenit në squfur;

d) reaktorët e përdorur në industrinë kimike;

dh) furrat e prodhimit të koksit;

e) furrat me tulla refraktare për prodhimin e gazit të nxehtë;

ë) aparaturat teknike, që përdoren për lëvizjen e automjeteve, anijeve ose avionëve;

f) turbinat e gazit, që përdoren në platformat në det;

g) turbinat e gazit, për funksionimin e të cilave është marrë leje para datës së hyrjes në fuqi të këtij ligji;

gj) çdo impiant që funksionon me motorë të ushqyer me benzinë, naftë ose gaz.

3. Në rastin kur dy a më shumë impiante të reja me djegie instalohen në mënyrë të tillë që, sipas vlerësimit të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, që merr parasysh faktorët teknikë dhe ekonomikë të tyre, mbetjet e gazta të tyre mund të shkarkohen nga një oxhak i përbashkët, kombinimi që përftohet prej tyre konsiderohet si një njësi e vetme.

Neni 13

Programet e pakësimit të shkarkimeve

1. Ministria harton programet për pakësimin e vazhdueshëm të shkarkimeve të përgjithshme vjetore nga impiantet ekzistuese me djegie. Këto programe do të përcaktojnë afatet kohore dhe procedurat që zbatohen për pakësimin e shkarkimeve.

2. Programet e pakësimit të shkarkimeve sigurojnë respektimin e tavaneve të shkarkimeve ose përqindjet e pakësimit të dyoksidit të squfurit dhe oksideve të azotit, të përcaktuara në ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

3. Programi i pakësimit të shkarkimeve mund të rishikohet, në përputhje me kushtet e reja të krijuara, kur një ndryshim i ndjeshëm dhe i papritur i kërkesës për energji, i disponibilitetit të disa lëndëve djegëse të caktuara apo instalimeve të caktuara të gjenerimit të energjisë krijon vështirësi teknike serioze për zbatimin e tij. Rishikimi mund të përfshijë rishikimin e tavaneve të shkarkimeve ose të datave të vendosura për respektimin e këtyre tavaneve të shkarkimeve.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton rregullat e hollësishme për hartimin, miratimin, rishikimin dhe zbatimin e programeve të pakësimit të shkarkimeve.

Neni 14

Vlerat kufi të shkarkimeve

1. Leja e mjedisit e tipit A për impiantet e reja me djegie përmban kushte për shkarkimet e dyoksidit të squfurit, oksideve të azotit dhe pluhurave, të cilat nuk janë më pak shtrënguese se vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në pjesën B të shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji.

2. Leja e mjedisit e tipit A për impiantet ekzistuese me djegie përmban të dhëna për planin e përputhshmërisë, i cili siguron që, brenda datës 1 janar 2012, shkarkimet e dyoksidit të squfurit, oksideve të azotit dhe pluhurave do të jenë pakësuar deri, të paktën, në nivelin e vlerave kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në pjesën A të shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të përjashtojë një impiant ekzistues me djegie nga detyrimi për përputhshmëri me vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, në qoftë se:

a) operatori i atij impianti ekzistues me djegie, në marrëveshje me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, pranon, si pjesë të kushteve të lejes së mjedisit të tipit A, që ka kërkuar, të mos e shfrytëzojë impiantin me djegie më shumë se 20 000 orë pune nga data e marrëveshjes deri në një datë jo më të vonë se data 31 dhjetor 2025;

b) operatori, si kusht të lejes së mjedisit të tipit A, ka detyrimin të paraqesë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit, si pjesë të raportit të tij vjetor, një regjistër, ku përcaktohen koha e përdorur dhe ajo e papërdorur, në raport me kohën totale të lejuar për funksionimin e atij impianti me djegie.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për një impiant me djegie, i cili, në kushte normale, përdor lëndë djegëse me përmbajtje të ulët squfuri, mund të lejojë pezullimin e detyrimit për respektimin e vlerave kufi të shkarkimeve të dyoksidit të squfurit, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, në rastet kur:

a) operatori nuk ka mundësi të respektojë vlerat kufi të shkarkimeve, për shkak të ndërprerjes së furnizimit me lëndë djegëse me përmbajtje të ulët squfuri, si pasojë e mungesës objektive të saj në treg;

b) periudha e pezullimit nuk zgjat më shumë se gjashtë muaj.

5. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të lejojë përjashtimin e një impianti me djegie që, në kushte normale, të përdorë vetëm lëndë djegëse të gazta, nga detyrimi për respektimin e vlerave kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, në qoftë se:

a) ai impiant, në mënyrë përjashtimore dhe vetëm kur për shkak të një ndërprerjeje të papritur të furnizimit me gaz mund të përdorë, për një periudhë kohe jo më të gjatë se 10 ditë, lëndë djegëse të tjera që në kushte normale, për të respektuar vlerat kufi të sipërpërmendura, duhej të shoqëroheshin me një impiant pastrimi të mbetjeve të gazta;

b) afati prej 10 ditësh, i referuar në shkronjën "a" të pikës 5 të këtij neni, mund të zgjatet për shkak të nevojës madhore për furnizim të vazhdueshëm me energji;

c) operatori përkatës njofton paraprakisht Agjencinë Kombëtare të Mjedisit.

6. Në rastin e impianteve me njësi djegieje me shumë lëndë djegëse, vlerat kufi të shkarkimeve vendosen në përputhje me shtojcën 8 të këtij ligji.

Neni 15

Mbetjet e gazta

1. Mbetjet e gazta nga impiantet me djegie shkarkohen në mënyrë të kontrolluar nëpërmjet një oxhaku.

2. Leja e mjedisit e tipit A, sipas rastit, përmban edhe kushtet e hollësishme për shkarkimin e mbetjeve të gazta.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur merr në konsideratë kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, siguron që lartësia e oxhakut të përmendur në pikën 1 të këtij neni, të llogaritet në mënyrë të tillë që të ruajë shëndetin e njeriut dhe mjedisin.

Neni 16

Keqfunksionimet ose avaritë

1. Leja e mjedisit e tipit A, për çdo impiant me djegie përmban kushte lidhur me keqfunksionimet ose avaritë e pajisjeve për pakësimin e ndotjes.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, në rast avarie, kur kthimi në funksionimin normal të impiantit nuk është i mundur brenda 24 orëve, i kërkon operatorit të impiantit me djegie pakësimin ose ndalimin e operacioneve apo vazhdimin e funksionimit të impiantit me djegie, duke përdorur lëndë djegëse më pak ndotëse. Në asnjë rast, koha e përgjithshme e funksionimit në kushte avarie të një impianti me djegie nuk mund të jetë më shumë se 120 orë në 12 muaj.

3. Operatori njofton Agjencinë Kombëtare të Mjedisit brenda 48 orëve nga ndodhja e avarisë.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të lejojë përjashtimin e impiantit me djegie, ku ka

ndodhur avaria, nga kufizimi prej 24 orësh dhe 120 orësh, të referuar në pikën 2 të këtij neni, kur vlerëson se:

a) ka një nevojë madhore për furnizim të vazhdueshëm me energji;

b) impianti me djegie, ku ka ndodhur avaria, do të zëvendësohet brenda një periudhe të kufizuar kohe nga një impiant tjetër me djegie, i cili do të shkaktonte një rritje të përgjithshme të shkarkimeve.

Neni 17

Impiantet me prodhim të kombinuar të energjisë elektrike e nxehtësisë dhe depozitimi gjeologjik i dyoksidit të karbonit

1. Agjencia Kombëtare e Mjedisit në vlerësimin e kërkesës për leje mjedisi të tipit A, për një instalim të ri me djegie, shqyrton mundësinë teknike dhe ekonomike për realizimin e prodhimit të kombinuar të energjisë elektrike dhe nxehtësisë. Kur konfirmohet kjo mundësi, instalimet zhvillohen në përputhje me tregun dhe sistemin e shpërndarjes.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit vlerëson kërkesën për leje mjedisi të tipit A për një impiant me djegie, me prodhim nominal energjetik prej 300 MW ose më shumë, të cilit i është dhënë leja e parë e ndërtimit pas datës 25 qershor 2009, nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

a) ka në dispozicion vende të përshtatshme për depozitimin e CO_2;

b) mjetet e transportimit janë teknikisht dhe ekonomikisht të mundshme;

c) është ekonomikisht dhe teknikisht e mundshme që investimi për kapjen e CO_2 të bëhet në këtë kohë të mëvonshme.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit përcakton nëse kushtet e parashikuara në pikën 2 të këtij neni plotësohen, duke gjykuar në bazë të vlerësimit të bërë nga kërkuesi në kërkesën për leje mjedisi, si dhe të çdo informacioni tjetër që lidhet në mënyrë të veçantë me mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit të njeriut.

4. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur vlerëson se kushtet e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni plotësohen, kërkon që në vendndodhjen e atij impianti të vihet në dispozicion hapësira e nevojshme për vendosjen e pajisjeve të nevojshme për kapjen dhe ngjeshjen e CO_2.

Neni 18

Shtimi i kapacitetit ose ndryshimi thelbësor në funksionim

1. Vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në pjesën B të shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji, zbatohen për pjesën më të re të impiantit me djegie, kur kapaciteti termik i tij shtohet me të paktën 50 MW. Vlerat kufi të shkarkimeve përcaktohen në raport me kapacitetin termik të të gjithë impiantit me djegie. Kjo dispozitë nuk zbatohet në rastet e referuara në shtojcën 8 pika 2 të këtij ligji.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, kur operatori i një impianti me djegie propozon një ndryshim thelbësor në funksionimin e tij, vendos në lejen e mjedisit të tipit A kushte që përcaktojnë se vlerat kufi për dyoksidin e squfurit, oksidet e azotit dhe pluhurin të jenë jo më pak shtrënguese se vlerat kufi të shkarkimeve, të përcaktuara në shtojcat 3 deri 7 të këtij ligji.

Neni 19

Vetëmonitorimi

1. Leja e mjedisit e tipit A, për një impiant me djegie, përmban kushte që sigurojnë se operatori i atij impianti:

a) vetëmonitoron shkarkimet e impiantit me djegie, në përputhje me shtojcën 9 të këtij ligji;

b) vetëmonitoron të gjitha vlerat e tjera për të siguruar respektimin e dispozitave të lejes së mjedisit të tipit A dhe të këtij ligji;

c) raporton në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe strukturën përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit brenda limiteve kohore të arsyeshme, për:

i) rezultatet e çdo procesi të vazhdueshëm vetëmonitorimi;

ii) verifikimin e saktësisë së çdo pajisjeje matëse;

iii) secilën matje;

iv) të gjitha matjet e tjera që kërkohen në lejen e mjedisit të tipit A, për të siguruar respektimin e dispozitave të lejes së mjedisit të tipit A dhe të këtij ligji.

2. Në rastet kur kërkohen matje të vazhdueshme të shkarkimeve, vlerat kufi të shkarkimeve sipas përcaktimit të pjesës A të shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji, konsiderohet se janë respektuar në qoftë se vlerësimi i rezultateve tregon se gjatë funksionimit të impiantit në orët e punës, brenda një viti kalendarik, pa marrë parasysh periudhat e ndezjes, të fikjes dhe avaritë:

a) Asnjë nga vlerat mesatare gjatë një muaji kalendarik nuk tejkalon vlerat kufi të shkarkimeve;

b) Në rastet kur për:

i) dyoksidin e squfurit dhe pluhurin: 97 për qind e të gjitha vlerave mesatare gjatë 48 orëve të punës nuk tejkalojnë 110 për qind të vlerave kufi të shkarkimeve;

ii) oksidet e azotit: 95 për qind e të gjitha vlerave mesatare gjatë 48 orëve të punës nuk tejkalojnë 110 për qind të vlerave kufi të shkarkimeve.

3. Në rastet kur kërkohen vetëm matje jo të vazhdueshme ose procedura të tjera të veçanta vlerësimi, vlerat kufi të shkarkimeve, sipas përcaktimit të shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji, konsiderohen të respektuara në qoftë se rezultatet e çdo grupi matjesh nuk tejkalojnë vlerat kufi të shkarkimeve.

4. Vlerat kufi të shkarkimeve, gjatë funksionimit të një impianti të ri me djegie, në orët e punës brenda një viti kalendarik, pa marrë parasysh periudhat e ndezjes, fikjes dhe avaritë, konsiderohen të respektuara, nëse:

a) asnjë vlerë mesatare ditore e vërtetuar nuk tejkalon vlerat e përcaktuara në pjesën B të shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji;

b) 95 për qind e të gjitha vlerave mesatare ditore, të vërtetuara përgjatë një viti, nuk tejkalojnë 200 për qind të vlerave përkatëse, sipas përcaktimit të bërë në pjesën B të shtojcave 3 deri 7 të këtij ligji.

"Vlerat mesatare të validuara", të referuara në shkronjat "a" dhe "b" të kësaj pike, përcaktohen në përputhje me sa parashikon pika 7 e shtojcës 9 të këtij ligji.

5. Operatori i secilit impiant me djegie raporton, çdo vit, në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe strukturën përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit për secilin impiant në një vendndodhje të caktuar:

a) shkarkimet vjetore të përgjithshme të SO_2, NO_x dhe pluhurat (si total i grimcave pezull);

b) sasinë vjetore të përgjithshme të energjisë së shfrytëzuar, lidhur me vlerën kalorifike neto, të zbërthyer në pesë kategori lëndësh djegëse: biomasë, lëndë të tjera djegëse të ngurta, lëndësh djegëse të lëngshme, gaz natyror, gaze të tjera.

6. Agjencia Kombëtare e Mjedisit mban dhe përditëson një regjistër që përmbledh:

a) informacionin e mbledhur, në përputhje me përcaktimet e pikës 5 të këtij neni;

b) të dhënat për çdo periudhë kohe të lejuar, të përdorur ose jo, dhe për jetëgjatësinë funksionale të mbetur të impiantit me djegie.

KREU III
LEJET E MJEDISIT TË TIPIT B

Neni 20

Kërkesat e përgjithshme për funksionimin e lejes së mjedisit të tipit B

1. Pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, instalimet e kategorisë B pajisen me leje mjedisi të tipit B, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji.

2. E njëjta leje mjedisi e tipit B mund të lejojë funksionimin e më shumë se një instalimi të të njëjtit operator, në të njëjtën vendndodhje. Instalimet e operatorëve të ndryshëm, që ndodhen në të njëjtën vendndodhje dhe instalimet e të njëjtit operator, që ndodhen në vendndodhje të ndryshme kërkojnë leje të veçanta të tipave A dhe B, sipas rastit.

3. Agjencia Kombëtare e Mjedisit nuk e përgatit lejen e mjedisit të tipit B kur provon mbi baza objektive se:

a) pas zotërimit të asaj lejeje, kërkuesi nuk do të jetë operator i instalimit në fjalë;

b) kërkuesi nuk do të sigurojë funksionimin e instalimit, në përputhje me kushtet që do të përcaktohen në lejen përkatëse të mjedisit të tipit B.

Për qëllime të kësaj pike, merret në konsideratë edhe historia e deriatëhershme e këtij kërkuesi të lejes dhe/ose historia e deriatëhershme e instalimit.

KREU IV

(shfuqizuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

Neni 21

(shfuqizuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

KREU V

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME PËR LEJET E MJEDISIT

Neni 22

Efektet ndërkufitare në mjedis në territorin e një shteti tjetër

1. Ministri, kur informohet nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit se funksionimi i këtij instalimi në territorin e Republikës së Shqipërisë ka mundësi reale të krijojë efekte negative të konsiderueshme në mjedisin e një shteti tjetër, si dhe në rastet kur autoriteti kompetent i atij shteti, që mund të ndikohet negativisht në mënyrë të konsiderueshme, e kërkon atë, dhe i dërgon këtij:

a) një kopje të kërkesës për leje mjedisi të tipit A ose, sipas rastit, një kopje të kërkesës për rishikimin e lejes ekzistuese apo të kushteve të saj;

b) sipas rastit, kur kërkesa është subjekt i një vlerësimi ndërkombëtar ndërkufitar të ndikimit në mjedis, sipas ligjit nr.10 440, datë 7.7.2011 "Për vlerësimin e ndikimit në mjedis";

c) kontaktet e Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, ku mund të sigurohet më shumë informacion dhe ku duhet të dorëzohen komentet ose pyetjet;

ç) detajet për afatet e dorëzimit të këtyre komenteve apo pyetjeve;

d) natyra e vendimeve që mund të merren;

dh) sipas rastit, detajet e kërkesës për rishikim të lejes ekzistuese apo ndonjë prej kushteve të saj;

e) informacion për kohën, vendet apo mjetet, përmes të cilave mund të sigurohet ky informacion.

2. Këshilli i Ministrave miraton rregullat e komunikimit, konsultimit dypalësh dhe të vendimmarrjes, lidhur me lejen përkatëse të mjedisit të tipit A, për funksionimin e instalimit të vendosur në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe që ka mundësi reale të krijojë efekte negative të konsiderueshme në mjedisin e një shteti tjetër ose menjëherë pasi i kërkohet nga ky shtet.

Neni 23

Menaxhimi i informacionit

(shfuqizuar pika 2, zëvendësuar fjalë në pikat 3 dhe 4 me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

1. Të gjitha informacionet, lidhur me instalimet e kategorive A dhe B, bëhen publike dhe janë pjesë e sistemit të informacionit mjedisor, sipas përcaktimit të ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

2. Shfuqizuar.

3. Informacioni i referuar në pikën 1, të këtij neni përfshin rezultatet e vetëmonitorimit, që kërkohen si kusht për lejen përkatëse të atij instalimi.

4. Të dhënat, në pikën 1, të këtij neni, të cilat konsiderohen si sekret shtetëror, në zbatim të legjislacionit për informacionin e klasifikuar "Sekret shtetëror", apo janë subjekt i mbrojtjes së legjislacionit në fuqi për të dhënat personale, të dhënat profesionale apo të dhënat tregtare, nuk bëhen publike dhe nuk transferohen nga një autoritet në një tjetër, sipas përcaktimit të këtij ligji, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe sipas legjislacionit përkatës në fuqi.

Neni 24

Inspektimi

(shfuqizuar pika 2 me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020; ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Struktura përgjegjëse për inspektimin në mjedis kryen inspektime në instalimet e tipit A dhe B në përputhje me dispozitat e ligjit "Për mbrojtjen e mjedisit" dhe ligjit "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë.

2. Shfuqizuar.

3. Operatori i instalimit, mbi të cilin zbatohet ky ligj, i jep Inspektoratit Shtetëror Kompetent gjithë asistencën e nevojshme për kryerjen e inspektimeve në atë instalim, për marrjen e mostrave dhe grumbullimin e gjithë informacionit të nevojshëm për realizimin e detyrave të veta, për qëllime të këtij ligji dhe në përputhje me kërkesat e ligjit nr.10 431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit".

Neni 25

Tarifat për lejet e mjedisit

(ndryshuar pika 3, shfuqizuar pika 6 me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

1. Subjekti kërkues i lejes së mjedisit paguan tarifën përkatëse për:

a) kërkesë për leje mjedisi të tipave A dhe B;

b) kërkesë për një ndryshim të kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipit A ose të tipit B;

2. Tarifat për lejen e tipave A dhe B paguhen në ministri.

3. Operatori i instalimit i paguan çdo vit një tarifë vjetore ministrisë për instalimet e tipave A dhe B, përkatësisht.

4. Këshilli i Ministrave, me propozimin e ministrit, miraton vlerat përkatëse të tarifave, të përmendura në pikat 1 dhe 3 të këtij neni.

5. Ministria i kërkon QKB-së shfuqizimin e lejes përkatëse të mjedisit të tipave A ose B, në rast se operatori i këtij instalimi nuk ka kryer pagimin e tarifës përkatëse në zbatim të këtij ligji.

6. Shfuqizuar.

7. Të ardhurat që grumbullohen nga pagesa e tarifave të lejeve të mjedisit të tipave A dhe B derdhen në Buxhetin e Shtetit.

Neni 26

Heqja dorë nga leja e mjedisit

(hequr fjalë me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

1. Operatori i një veprimtarie, subjekt i një lejeje mjedisi të tipave A dhe B, sipas përcaktimit të këtij ligji, mund të bëjë një kërkesë në QKB për heqjen dorë, pjesërisht apo plotësisht, nga leja e mjedisit.

2. Ministri, sipas rastit, miraton heqjen dorë, pjesërisht apo plotësisht, nga leja e mjedisit, në qoftë se vlerësojnë se operatori ka marrë masat e nevojshme:

a) për të shmangur një rrezik ndotjeje nga veprimtaria e instalimit;

b) për të kthyer territorin e veprimtarisë në gjendje të kënaqshme, duke pasur parasysh gjendjen e këtij territori para se instalimi të fillonte veprimtarinë.

3. Ministria i përcjell QKB-së vendimin e miratimit të heqjes dorë nga leja e mjedisit.

Neni 27

Shfuqizimi i lejeve të mjedisit të tipave A dhe B

(ndryshuar titulli, ndryshuar fjalia hyrëse me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

Ministri, për lejet e mjedisit të tipave A dhe B, mund të pezullojë ose të shfuqizojë lejen e mjedisit kur:

a) paraqitet kërkesë nga vetë mbajtësi i lejes;

b) mbajtësi i lejes nuk përmbush kushtet e parashikuara në lejen e mjedisit;

c) mbajtësi i lejes është dënuar, sipas legjislacionit në fuqi, për një vepër penale në fushën e mjedisit apo ka kryer kundërvajtje administrative po në fushën e mjedisit;

ç) mbajtësi i lejes së mjedisit ka shkelur, në mënyrë të përsëritur, dispozitat e këtij ligji, gjë që ka çuar në vënien e gjobave administrative, në përputhje me nenin 30 të këtij ligji;

d) mbajtësi i lejes nuk ka paguar gjobat administrative, të vëna në bazë të këtij ligji apo të çdo akti tjetër normativ mjedisor.

Neni 28

Ankimi

Çdo palë e interesuar, subjekt i këtij ligji, ka të drejtë të ankimojë në rrugë administrative, me kërkesë në QKB, ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve të ministrit, apo agjencisë rajonale të mjedisit, gjatë procesit të pajisjes me leje mjedisore, sipas kërkesave të nenit 30 të ligjit nr.10 081, datë 23.2.2009 "Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë".

Neni 29

Kundërvajtjet

(Ndryshuar pikat 3, 4, 6, 7 dhe 12, shfuqizuar pika 5 me ligjin nr. 44/2013, datë 14.02.2013, shfuqizuar paragrafët "iii", të shkronjave "a" dhe "b", hiqen fjalë në pikën 2, ndryshuar pika 8 me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020; hequr togfjalësh në pikën 4, riformuluar pika 9 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Shkeljet e mëposhtme të këtij ligji, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje

administrative dhe dënohen si më poshtë:

a) Zhvillimi i veprimtarisë që është subjekt i një lejeje mjedisi të tipave A dhe B, sipas përcaktimeve të këtij ligji:

i) pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë;

ii) pa lejen përkatëse të mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë;

iii) Shfuqizuar ;

duke u shtuar me vlerën 10 për qind të masës të gjobës çdo ditë, deri në plotësimin e detyrimit.

b) Mospërmbushja dhe mosrespektimi i kërkesave, parimeve dhe kushteve të lejes përkatëse të mjedisit të tipave A dhe B nga operatori i një instalimi:

i) për lejet e mjedisit të tipit A, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë;

ii) për lejet e mjedisit të tipit B, dënohet me gjobë në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë;

iii) Shfuqizuar;

duke u shtuar me vlerën 10 për qind të masës të gjobës çdo ditë, deri në plotësimin e detyrimit.

c) Mosinformimi i Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori, në përputhje me përcaktimin e pikës 3 të nenit 16 të këtij ligji, dënohet me gjobë në vlerën nga 1 000 000 deri në 2 000 000 lekë, duke u shtuar me vlerën 10 për qind të masës të gjobës çdo ditë, deri në korrigjimin e mospërputhjes.

2. Informacioni që i jepet Agjencisë Kombëtare të Mjedisit nga operatori i një veprimtarie, subjekt i këtij ligji, nëpërmjet procesit të vetëmonitorimit, mund të përdoret për të vërtetuar përgjegjësinë penale apo administrative të atij operatori apo çdo personi tjetër në një çështje gjyqësore.

3. Pavarësisht nga dënimi kryesor me gjobë, të parashikuar në shkronjat "b" dhe "c" të pikës 1 të këtij neni, Agjencia Kombëtare e Mjedisit vetë ose me propozimin e Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës, mund t'i propozojë ministrit pezullimin apo shfuqimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë apo pjesë të saj, masë e cila është dënim plotësues.

4. Inspektori i Inspektoratit Shtetëror Përgjegjës shqyrton dhe merr përfundimisht vendimin në përputhje me këtë ligj dhe ligjin "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë".

5. Shfuqizuar.

6. Subjekti, ndaj të cilit vendoset masa administrative, mund të bëjë ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.

7. Gjoba paguhet brenda një periudhe prej 30 ditësh kalendarike.

8. Ministri, me propozimin e strukturës përgjegjëse inspektuese në fushën e mjedisit, në rastet kur gjoba nuk është paguar brenda afatit të përcaktuar, vendos pezullimin e lejes përkatëse të mjedisit për të gjithë veprimtarinë ose pjesë të saj deri në pagesën e gjobës. Vendimi i pezullimit publikohet menjëherë në Regjistrin Kombëtar të Licencave, Autorizimeve dhe Lejeve nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit dhe i dërgohet zyrtarisht QKB-së.

9. Subjekti ndaj të cilit merret masa e pezullimit pas shqyrtimit administrativ në strukturën përgjegjëse për inspektimin ka të drejtën e ankimit në gjykatën kompetente brenda 30 ditëve nga data e shpalljes së vendimit.

10. Të ardhurat që vijnë nga vjelja e gjobave dhe nga dhënia e lejeve mjedisore derdhen në Buxhetin e Shtetit.

11. Zbatimi i kundërvajtjeve administrative nuk e shmang subjektin përkatës nga detyrime të tjera të përcaktuara në këtë ligj dhe nga përgjegjësia civile për dëmin e shkaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

12. Çdo masë administrative e marrë në zbatim të këtij ligji ekzekutohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

KREU VI
DISPOZITAT KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 30

Dispozita të përkohshme për instalimet ekzistuese të tipit A dhe të tipit B

1. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit A dhe të tipit B do të zbatojnë të gjitha dispozitat e këtij ligji jo më vonë se tetë vjet nga hyrja në fuqi e tij.

2. Operatori i një instalimi ekzistues të tipit A ose të tipit B, brenda dy viteve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, i dërgon Agjencisë Kombëtare të Mjedisit, përmes QKB-së, kërkesën për rishikimin e kushteve të lejes ekzistuese të mjedisit të tipit A ose të tipit B, sipas rastit, në përputhje me kërkesat e reja të këtij ligji dhe planin e përputhshmërisë, së bashku me afatet përkatëse.

3. Plani i përputhshmërisë përmban informacionin e nevojshëm, sipas përcaktimit të shtojcës 10 të këtij ligji, dhe paraqet mënyrën sesi operatori siguron zbatimin e dispozitave të pikës 1 të këtij neni.

4. Çdo leje mjedisi e tipit A ose të tipit B për operatorin e një instalimi ekzistues, e rishikuar, merr parasysh planin e përputhshmërisë me afatet përkatëse. Ky plan pasi miratohet, bëhet pjesë përbërëse e asaj lejeje mjedisi dhe i njoftohet QKB-së.

5. Lejet e tjera të mjedisit që operatori ka marrë për atë instalim ekzistues, sipas përcaktimeve të legjislacionit për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, menaxhimin e mbetjeve apo zhurmave ose akte të tjera normative në fuqi, që lidhen me mbrojtjen e mjedisit, pushojnë efektet e tyre, duke filluar nga data kur bëhet e vlefshme leja e mjedisit të tipit A ose B, sipas rastit, e dhënë sipas këtij ligji dhe që rregullon e detyron mbi operatorin të njëjtat kushte që janë përfshirë në ndonjë nga ato leje të tjera ekzistuese.

6. Dispozitat, sipas përcaktimit të pikës 5 të këtij neni, nuk zbatohen për lejet për nxjerrjen e ujit, që janë subjekt i legjislacionit për mbrojtjen e ujit, zonat e mbrojtura dhe administrimin e mbrojtjen e pyjeve. Agjencia Kombëtare e Mjedisit bashkërendon veprimtarinë e saj me autoritetet përkatëse për dhënien e lejeve për nxjerrjen e ujit, për të siguruar një qasje efektive dhe të integruar të procesit të dhënies së kësaj lejeje, në veçanti kur merr vendime që lidhen me lejen e mjedisit të tipit A.

Neni 31

(shfuqizuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

Neni 32

Dispozita kalimtare për funksione institucionale

1. Funksionet e dhëna nga ky ligj Agjencisë Kombëtare të Mjedisit dhe agjencive përkatëse rajonale të mjedisit do të kryhen nga ministria në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit dhe agjencitë përkatëse rajonale të mjedisit, për një periudhë jo më të gjatë se katër vjet

2. Periudha kalimtare, sipas përcaktimit të pikës 1 të këtij neni, përfundon me urdhër të ministrit, i cili publikohet në Fletoren Zyrtare.

Neni 33

Raportimi për zbatimin e ligjit

1. Ministria publikon një raport për zbatimin e këtij ligji, brenda datës 30 tetor 2014, dhe çdo tre vjet për periudhën në vijim.

2. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Inspektorati Shtetëror Kompetent, agjencia rajonale e mjedisit, inspektorati rajonal i mjedisit, si dhe institucionet e tjera përkatëse i japin ministrisë informacionin e nevojshëm për përgatitjen e këtij raporti.

3. Formati i raportit miratohet nga ministri.

Neni 34
Aktet nënligjore

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 11, 13 pika 4, 22 pika 2 dhe 25 pika 4 të këtij ligji, brenda një periudhe 2-vjeçare nga data e botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

2. Ngarkohet ministri të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 32 pika 2 dhe 33 pika 3 të këtij ligji, brenda një periudhe 2-vjeçare nga data e botimit të tij në Fletoren Zyrtare.

Neni 35
Shfuqizime

1. Nenet 31, 33 dhe 34 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 "Për rezervat ujore", të ndryshuar, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

2. Neni 18 i ligjit nr.9115, datë 24.7.2003 "Për trajtimin mjedisor të ujërave të ndotura", shfuqizohet me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

3. Nenet 11 dhe 17 të ligjit nr.8897, datë 16.5.2002 "Për mbrojtjen e ajrit nga ndotja", të ndryshuar, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të këtij ligji.

Dispozitë kalimtare
(shtuar me ligjin nr. 44/2013, datë 14.02.2013)

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Dispozita kalimtare
(shtuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

1. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit referuar shtojcës 1, të këtij ligji, klasifikohen si leje mjedisit të tipit B, aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me leje mjedisi të tipit B brenda 12 muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit.

2. Të gjitha instalimet e cituara në pikën 1, të këtij neni, vazhdojnë të dorëzojnë raportin për zbatimin e kushteve të lejes së mjedisit të tipit C pranë agjencisë rajonale të mjedisit përkatës, deri në momentin që do të aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t'u pajisur me leje mjedisi të tipit B.

3. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat nuk klasifikohen si leje mjedisi të tipit B, sipas pikës 1, të këtij neni, me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen.

4. Kërkesat e posaçme për shqyrtimin e aplikimeve për leje mjedisi të tipit B, për instalimet e cituara në pikën 1, të këtij neni, si dhe rregullat e hollësishme për shqyrtimin e tyre nga autoritetet

kompetente, të përcaktuara në këtë ligj, deri në lëshimin e këtyre lejeve nga QKB-ja, do të miratohen me urdhër të ministrit, brenda 1 muaji, nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

Neni 36

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 18 muaj pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.7063, datë 27.7.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

SHTOJCA 1

(ndryshuar me ligjin nr. 60/2014, datë 19.6.2014, ndryshuar me ligjin nr. 52/2020, datë 30.4.2020)

Shtojca 1

Lejet e mjedisit të tipave A dhe B, në varësi të kapacitetit prodhues kufi

Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull, si më poshtë, dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mblidhen bashkë. N.q.s. nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti **kufi** nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo.

	ID	**Veprimtaria**	**Kapaciteti kufi për lejet e tipit A**	**Kapaciteti kufi për lejet e tipit B**
Industritë energjetike	1.1	Instalimet me djegie.	Energjia termike në hyrje është e barabartë ose më e madhe se 50 MW.	Inputi (energjia) termike është më e vogël se 50 MW.
	1.2	Rafineritë e hidrokarbureve, naftës dhe nënprodukteve të saj dhe gazit.	Të gjitha instalimet.	
	1.3	Furrat e koksit.	Të gjitha instalimet.	
	1.4	Instalimet e gazifikimit dhe lëngëzimit të qymyrit.	Të gjitha instalimet.	
	1.5	Kërkimi i naftës dhe i gazit natyror .	Të gjitha instalimet.	
	1.6	Nxjerrja e naftës dhe e gazit natyror.	Të gjitha instalimet.	
	1.7	Gaz natyror aromatik ose GNL, përveç rasteve kur veprimtaria është e lidhur me tipin		Të gjitha instalimet.

		A, ose përzierje e aromave.		
	1.8	Përzierje aromash për t'u përdorur me gazin natyror ose naftën e lëngështuar.		Të gjitha instalimet.
	1.9	Shpërndarja dhe magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj: a. magazinimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisterna të palëvizshme në ndonjë terminal , ose ngarkim/shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në/nga një cisternë e lëvizshme, cisternë hekurudhore, ose anije e ujërave të brendshme në terminal; b. shkarkimi i naftës dhe nënprodukteve të saj në cisternat e stacioneve të furnizimit me karburant.		Të gjitha instalimet.
	1.10	Furnizim me karburant i makinave në një stacion të furnizimit me karburant në zonat urbane.		Të gjitha instalimet.
Prodhimi dhe përpunimi i metaleve	2.1	Pjekja ose aglomerimi i xeherorëve metalikë (përfshirë xeherorët sulfur).	Të gjitha instalimet.	
	2.2	Prodhim i gizës ose çelikut (shkrirje primare dhe sekondare) duke përfshirë derdhjen e vazhdueshme.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 2,5 ton/orë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 2,5 ton/orë ose më i vogël se kaq.
	2.3	a. Përpunim i metaleve ferrose – me mullinj me rula në të nxehtë.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 ton çelik bruto në orë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 ton çelik bruto në orë ose më i vogël se kaq.
		b. Përpunim i metaleve ferrose - me farkëtim.	Energjia është më e madhe se 50 kilojoule për goditës, dhe fuqia kalorifike është më e madhe se 20 MW.	Energjia është e barabartë me 50 kilojoule për goditës ose më pak se kaq, dhe fuqia kalorifike është e

				barabartë me 20 MW, ose më pak se kaq.
		c. Përpunim i metaleve ferrose - dhe aplikimi i veshjes me metal të shkrirë.	Furnizimi i procesit me materiale është më i madh se 2 ton/orë çelik bruto.	Hyrja është e barabartë me 2 ton/orë çelik bruto ose më pak se kaq.
	2.4	Fonderitë e metaleve ferrose.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
	2.5	a. Prodhim bruto i metaleve me ngjyrë nga xeherorët, nga koncentratet ose lëndë të para dytësore nga procese metalurgjike, kimike ose elektrolitike.	Të gjitha instalimet.	
		b. Shkrirja dhe përftimi i aliazheve të metaleve jo-ferrose (me ngjyrë) përfshirë produktet e rikuperuar (duke përfshire rafinimin dhe derdhjen në fonderi).	Kapaciteti shkrirës është më i madh se 4 ton/ditë për plumbin ose kadmiumin, ose më i madh se 20 ton/ditë për të gjitha metalet e tjera.	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 4 ton/ditë për plumbin ose kadmiumin ose më pak se kaq, ose 20 ton/ditë për të gjitha metalet e tjera.
	2.6	Trajtime sipërfaqësore të metaleve dhe plastikave duke përdorur procese elektrolitike ose kimike.	Volumi i depozitës së trajtimit më i madh se 30 m^3.	Volumi i depozitës së trajtimit është i barabartë me 30 m^3 ose më pak se kaq.
Industria minerare	3.1	a. Prodhimi i klinkerit të çimentos në furra rrotulluese.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 500 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 500 ton/ditë ose më pak se kaq.
		b. Prodhim i gëlqeres në furra rrotulluese.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 50 ton/ditë, ose më pak se kaq.
		c. Prodhim i klinkerit të çimentos ose gëlqeres në furra të tjera.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq
		d. Magazinimi, ngarkimi ose shkarkimi në masë të madhe i çimentos ose i klinkerit të çimentos përpara transportimit të tyre në masë të madhe.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
		e. Përzierja e çimentos ose përdorimi i çimentos në masë të madhe por jo në sheshin e ndërtimit, përfshirë ambalazhimin dhe përzierjen e çimentos, grumbullimi i		Të gjitha instalimet.

		betonit dhe prodhimi i blloqeve të betonit dhe produkteve të tjera të çimentos, si dhe prodhimi i llaçit, kollës, gëlqeres (parafabrikateve, paletave, etj.).		
	3.2	a. Prodhim i asbestit ose i produkteve me bazë asbesti.	Të gjitha instalimet.	
		b. Prodhim i produkteve me bazë asbesti.	Të gjitha instalimet.	
		c. Nxjerrje e asbestit nga mjetet e transportit hekurudhor, me përjashtim të rasteve: i) gjatë riparimit ose mirëmbajtjes së makinerisë; ii) gjatë operacioneve të rikuperimit pas një aksidenti, ose iii) në rastet kur asbesti është mbuluar përgjithnjë me çimento ose ndonjë material tjetër (përfshirë plastikën, gomën ose rrëshirën).		Të gjitha instalimet.
		d. Shkatërrimi i mjeteve të transportit hekurudhor përmes djegies kur asbesti është i inkorporuar ose është shpërndarë në gjithë strukturën e tij.		Të gjitha instalimet.
		e. Lustrimi industrial duke përfshirë gdhendjen, shpimin ose montimin e produkteve të prodhuara prej asbesti, ose ndonjërit nga produktet e mëposhtme që nuk janë të lidhura me prodhimin – i) filtrat prej asbesti ii) produktet e fërkimit prej asbesti		Të gjitha instalimet.

		iii) lidhjet, paketimet dhe materialet e përforcimit prej asbesti; iv) paketimet prej asbesti; v) tekstilet prej asbesti.		
	3.3	Prodhimi i qelqit dhe fibrave të qelqit.	Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
	3.4	a. Shkrirje e substancave minerare.	Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
		b. Prodhimi i substancave minerare.	Kapaciteti shkrirës është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti shkrirës është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
	3.5	a. Prodhim i produkteve qeramike nëpërmjet pjekjes, përfshirë tjegullat, tullat, tullat refraktare, pllakat, prodhimet e poçerisë/qeramikës apo të porcelanit.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 75 ton/ditë, dhe/ose kapaciteti i furrës, është më i madh se 4 m^3 dhe me densitet vendosje që është më i madh se 300 kg/m^3 për çdo furrë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 75 ton/ditë, ose më pak se kaq, dhe/ose kapaciteti i furrës është i barabartë me 4 m^3 ose më pak se kaq dhe me densitet vendosje për çdo furrë që është i barabartë me 300 kg/m^3, ose më pak se kaq.
		b. Pjekje e produkteve prej argjile të rëndë ose produkte zjarrduruese, përveçse produkteve prej argjile të rëndë në një furrë ku veprimtaria nuk përfshihet në përshkrimin e kategorisë 3,5 a më lart.		Të gjitha instalimet.
		c. Lustrim me avull të produkteve prej balte (poçeri/qeramikë), ose prej argjile me kripëra.		Të gjitha instalimet.
	3.6	Minierat nëntokësore dhe veprimtaritë e lidhura me to.		Të gjitha instalimet.
	3.7	Nxjerrja e mineraleve, rërës dhe argjilës nga minierat me shfrytëzim në qiell të hapur dhe nga guroret .		Të gjitha instalimet.
	3.8	Gërmimet nën ujërat bregdetare ose ujërat sipërfaqësore kontinentale.		Të gjitha instalimet.

	3.9	Përpunimi, prerja dhe lustrimi i mermerit dhe gurëve dekorativ.		Kapaciteti përpunues është i barabartë me 5 m^3/ditë ose më i madh se kaq.
	3.10	Prodhimi i produkteve abrazive.		Të gjitha instalimet
	3.11	Prodhimi dhe fraksionimi i produkteve minerale jometalike.		Të gjitha instalimet.
	3.12	Impiantet e pasurimit të mineraleve.		Të gjitha instalimet.
Industria kimike (1)	4.1	Prodhimi i kimikateve organike bazë (2).	Të gjitha instalimet.	
	4.2	Prodhimi i kimikateve inorganike bazë (3).	Të gjitha instalimet.	
	4.3	Prodhim i plehëruesve me bazë fosfori-azoti ose potasiumi (plehërues të thjeshtë apo të përzier).	Të gjitha instalimet.	
	4.4	Prodhim i produkteve bazë për shëndetin e bimëve dhe të biocideve.	Të gjitha instalimet.	
	4.5	a. Prodhim i produkteve farmaceutike bazë me anë të proceseve kimike ose biologjike.	Të gjitha instalimet.	
		b. Përpunimi/ përzierja e produkteve farmaceutike bazë.		Të gjitha instalimet.
	4.6	Prodhim i eksplozivëve.	Të gjitha instalimet.	
	4.7	Magazinimi i kimikateve, përveçse kur paraqiten si pjesë e ndonjë veprimtarie tjetër të tipit A ose tipit B, dhe përveç ndodhjes në një cisternë të lëvizshme.		I barabartë ose më i madh se limitet e mëposhtme: Secili ose disa prej akriloideve 20 tonë; Akrilonitrilet 20 tonë; Amoniak anhidrid prej 100 tonë; Fluorur hidrogjeni anhidrid 1 tonë; Toluen di-isocianati 20 tonë; Monomer klorid vinyl 20 tonë; Etilene 8000 tonë.
	4.8	Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e produkteve kozmetike.		Të gjitha instalimet.
	4.9	Prodhimi dhe përpunimi/përzierja e		Të gjitha instalimet.

		produkteve të pastrimit/ detergjenteve.		
Menaxhimi i mbetjeve	5.1	a. Incinerimi i mbetjeve të rrezikshme në një instalim incinerimi.	Të gjitha instalimet.	
		b. Incinerimi i mbetjeve urbane jo të rrezikshme.	Të gjitha instalimet.	
		c. Incinerim i mbetjeve duke përfshirë mbetjet e kafshëve në një instalim incinerimi, përveç atij të referuar në pikën 5.1 a	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenjuar për të djegur mbetje me intensitet më shumë se 1 ton/orë.	Instalimi i incinerimit përdoret ose është dizenjuar për të djegur mbetje me intensitet të barabartë me 1 ton/orë ose më pak se kaq.
	5.2	a. **Lendfilli** i mbetjeve (D1) duke përjashtuar lendfillin e mbetjeve inerte.	Kapaciteti i depozitimit është më i madh se 10 ton/ditë ose kapaciteti i dizenjuar i lendfillit është më i madh se 25000 tonë.	Kapaciteti depozitues është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq ose kapaciteti i dizenjuar i lendfillit është 25000 tonë ose më pak se kaq.
		b. Lendfill i mbetjeve inerte.		Të gjitha instalimet.
	5.3	a. Asgjësimi i mbetjeve të rrezikshme përveç incinerimit (5.1.a) ose lendfillimit (5.2 a).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq.
		b. Asgjësimi i vajrave të përdorur përveç incinerimit (5.1 a) ose lendfillimit (5.2.a).	Kapaciteti i përpunimit është me i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 10 ton/ditë, ose më pak se kaq.
		c. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim biologjik (D8).	Kapaciteti përpunimit është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
		d. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme me trajtim fiziko – kimik (D9).	Kapaciteti i përpunimit është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti i përpunimit është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq.
		e. Asgjësimi i mbetjeve jo të rrezikshme me metoda të tjera përveç (D1), (D8) ose (D9).		Të gjitha instalimet.
	5.4	a. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R1, R5, R6, R8, ose R9.	Të gjitha instalimet.	
		b. Rikuperim i mbetjeve të rrezikshme me anë të operacioneve R2, R3, R4, R7 ose R10.		Të gjitha instalimet.

		c. Rikuperim i mbetjeve jo të rrezikshme		Të gjitha instalimet.
	5.5	Magazinim i hekurishteve/skrapeve të metalit që nuk përmbajnë materiale të rrezikshme.		Kapaciteti i barabarte me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
	5.6	a. Pastrim, larje sprucim ose veshje e mbetjeve të ambalazheve/ paketimeve ose kontejnerëve në mënyrë që të ripërdoren.		Kapaciteti i barabarte me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
		b. Magazinim i mbetjeve në lidhje me zbatimin e veprimtarive të pikës 5.6 a.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/dite ose më i madh se kaq.
	5.7	Magazinim, trajtim, riparim ose rinovim i mbetjeve të pajisjeve elektrike dhe elektronike (WEEE).		Të gjitha instalimet.
	5.8	Magazinim, rikuperim i hekurishteve/ skrapeve të metalit ose çmontim i mbetjeve nga motorët e makinave.		Të gjitha instalimet.
	5.9	Magazinim i përkohshëm i mbetjeve duke përfshirë tepricat e produkteve nga kontejnerët ose nga larjet e kontejnerëve, dhe çdo mbetje të rrezikshme në mjediset pritëse të një zone portuale dhe ku mbetjet janë magazinuar për jo më shumë se 7 ditë.		Të gjitha instalimet.
	5.10	a. Stacion transferimi për mbetje të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Të gjitha instalimet.
		b. Stacion transferimi për mbetje jo të rrezikshme që nuk përmendet më lart.		Kapaciteti i barabartë me 50 ton/ditë ose më i madh se kaq.
	5.11	Kompostim i mbetjeve bio.		Kapaciteti i kompostimit më i madh se 50 ton/ditë.
	6.1	Instalim trajtimi për ujërat e ndotura urbane.		Të gjitha instalimet.

Trajtimi i ujërave dhe ujërave të zeza	6.2	Trajtimi i ujërave të ndotura industriale në vendin ku krijohen.		Të gjitha instalimet.
	6.3	Përdorimi i llumit të ujërave të zeza në tokë.		Të gjitha instalimet.
	6.4	Magazinim dhe/ose trajtim i mbetjeve të tjera të ujërave të zeza urbane duke përfshirë: - llumin nga ujërat e ndotura urbane; - llumin e cisternave septike; - mbetjet e ujërave të zeza nga gropa të hapura; - mbetjet nga pastrimi i kanaleve të ujërave të zeza.		Kapaciteti i trajtimit i barabartë ose më i madh se 30 m^3/ditë. Kapaciteti magazinues i barabartë ose më i madh se 50 m^3 vëllim depozitues.
Veprimtaritë e prodhimit të letrës, pulpës dhe dërrasës	7.1	a. Prodhim i pulpës nga trungjet e drurit dhe materiale të tjera fibroze.	Të gjitha instalimet.	
		b. Prodhim i letrës dhe/ose i kartonit.	Kapaciteti prodhues është më i madh se 20 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues është i barabartë me 20 ton/ditë ose më pak se kaq.
		c. Prodhim i dërrasës me ristela dhe me fibra, kompresat ose me çdo përbërje tjetër me bazë druri.		Të gjitha veprimtaritë.
Veprimtaritë e karbonit	7.2	Prodhim i karbonit ose qymyrit që digjet me vështirësi me anë të djegies ose grafitizimit.	Të gjitha instalimet.	
Veprimtaritë e katranit dhe të bitumit	7.3	a. Distilim i katranit ose i bitumit në lidhje me ndonjë proces prodhimi.		Të gjitha instalimet.
		b. Ngrohjen e katranit për prodhimin e elektrodave ose materialeve refraktare me bazë karboni.		Të gjitha instalimet.
		c. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b, ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë ngrohjen, por jo distilimin e katranit ose		Të gjitha instalimet.

		bitumit në lidhje me ndonjë veprimtari prodhimi.		
		d. Veprimtaritë që nuk përfshihen në pikat 7.3.a ose 7.3.b ose në pika të tjera të kësaj Shtojce, që përfshijnë oksidimin e bitumit duke fryrë ajër përmes saj, në fabrikën ku nuk kryhet asnjë nga aktivitetet e përshkruara në ndonjë seksion të kësaj shtojce.		Të gjitha instalimet.
Përpunimi i tekstileve ose fibrave	7.4	Fabrika për trajtimin paraprak ose ngjyrosjen e tekstileve dhe fibrave (veprime të tilla si: larje, zbardhje, mercerizim).	Kapaciteti përpunues është më i madh se 10 ton/ditë.	Kapaciteti përpunues është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq.
Përpunimi i gëzofit	7.5	Instalime për krehjen dhe lyerjen e gëzofëve.		Kapaciteti përpunues është më i madh se 10 ton/ditë.
Trajtimet me regjie dhe prodhimi i lëkurës	7.6	a. Regjia e lëkurëve të papunuara dhe shollave.	Kapaciteti trajtues është më i madh se 12 ton/ditë produkt të përfunduar.	Kapaciteti përpunues është i barabartë me 12 ton/ditë produkt të përfunduar ose më pak se kaq.
		b. Prodhime të produkteve të lëkurës përveç rastit kur është pjesë e një veprimtarie tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
Prodhimi i ushqimeve dhe pijeve dhe veprimtaritë e lidhura me to	7.7	a. Thertore.	Kapaciteti prodhues i karkasave është më i madh se 50 ton/ditë.	Kapaciteti prodhues i karkasave është i barabartë me 50 ton/ditë ose më pak se kaq, por gjithsesi më shumë se 2 ton/ditë
		b. Asgjësim ose riciklim i karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve, me mënyra të tjera përveç shndërrimit ose incinerimit, të përmendura në ndonjë veprimtari tjetër të kësaj shtojce.	Kapaciteti i trajtimit është më i madh se 10 ton/ditë të karkasave të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë.	Kapaciteti i trajtimit është i barabartë me 10 ton/ditë ose më pak se kaq karkasa të kafshëve ose mbetjeve të kafshëve ose të dyja bashkë.
		c. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e ushqimeve nga lëndët e para nga	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 75 tonë në ditë.	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 75 tonë në ditë ose më pak se kaq, por më shumë se 5 ton/ditë.

		kafshët (përveç qumështit).		
		d. Trajtimi dhe përpunimi i materialeve të nevojshme për prodhimin e produkteve ushqimore nga lëndët e para vegjetale.	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është më i madh se 300 tonë në ditë (vlerë mesatare duke u bazuar në të dhëna trimestrale).	Kapaciteti i prodhimit të produktit të përfunduar është i barabartë me 300 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat trimestrale), por më shumë se 10 ton/ditë.
		e. Trajtimi dhe përpunimi i qumështit.	Sasia e qumështit në hyrje është më e madhe se 200 ton/ditë (vlerë mesatare bazuar në të dhëna vjetore).	Sasia e qumështit në hyrje është e barabartë me 200 tonë në ditë ose më pak se kaq (vlerë mesatare bazuar në të dhënat vjetore), por më shumë se 2 ton/ditë.
		f. Trajtim ose magazinim i peshqve të ngordhur ose mbetjeve të peshqve.		Të gjitha instalimet.
		g. Prodhim dhe ambalazhim i pijeve joalkoolike (përveç ujit).		Të gjitha instalimet.
		h. Prodhim i alkoolit dhe pijeve alkoolike.		Kapaciteti prodhues mbi 20000 l/vit.
		i. Prodhimi i birrës.		Të gjitha instalimet.
		j. Prodhim i produkteve të frutave.		Të gjitha instalimet.
		k. Prodhim i xhelatinës dhe i materialeve ngjitëse nga lëkurat dhe kockat.		Të gjitha instalimet
		l. Prodhimi i produkteve të duhanit.		Kapaciteti prodhues mbi 2 ton/vit
		m. Prodhim i ushqimit për kafshë.		Të gjitha instalimet.
Blegtoria	7.8	a. Rritje intensive e shpendëve në një instalim.	Me kapacitet më shumë se 40000 (krerë) vende shpendësh.	Me kapacitet 40000–1000 (krerë) vende shpendësh.
		b. Rritje intensive e derrave në një instalim.	Me kapacitet më shumë se 2000 (kokë) vende për derra me peshë mbi 30 kg.	Me kapacitet 2000–200 (kokë) vende për derra me peshë mbi 30 kg.
		c. Rritje intensive e derrave në një instalim.	Me kapacitet më shumë se 750 (kokë) vende për dosa.	Me kapacitet 750–100 (kokë) vende për dosa.
		d. Rritje intensive e gjedhit në një instalim.		Me kapacitet më shumë se 50 (njësi) vende gjedhi.
		e. Rritje intensive e kafshëve të tjera të cilat		Bazuar në mënyrën e konvertimit të kafshëve të tjera në njësi gjedhi (me

		nuk janë përmendur më lart.		rregullore të Ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave).
Veprimtaritë e mbulimit të sipërfaqes dhe të stampimit	7.9	a. Instalimet për trajtimin e sipërfaqes së substancave, objekteve ose produkteve duke përdorur tretës. organikë, në mënyrë të veçantë për t'i krehur, stampuar, veshur me cipë, zhvajosur, mbrojtur nga uji, kalibruar, lyer, pastruar ose regjur/ngopur/lagur në thellësi.	Kapaciteti konsumues është më shumë se 150 kg/orë ose më shumë se 200 ton/vit.	Kapaciteti konsumues është 150 kg/orë, ose më pak, ose 200 ton/vit, ose më pak se kaq.
		b. Aplikimi ose heqja e materialeve veshëse që përmbajnë ndonjë përbërës tributyltin ose triphenyltin, n.q.s. ndodhet në kantier detar.		Kantier detar ku anijet me një gjatësi prej 25 m ose më shumë mund të ndërtohen, mirëmbahen ose riparohen.
		c. Riparim ose ri-sprucim i avionëve ose mjeteve të transportit hekurudhor ose pjesëve të tyre.		Të gjitha instalimet.
		d. Ri-ngjyrosje ose risprucim i mjeteve të transportit rrugor ose pjesëve të tyre.		Ka gjasa që në çdo periudhë 12-mujore veprimtaria të përdorë 1 ton solvente organike.
		e. Përveç rasteve të përmendura në 7.9.c dhe 7.9.d, çdo proces (duke përjashtuar ri-ngjyrosjen ose ri-sprucimin plotësisht ose pjesërisht të avionëve, mjeteve të transportit hekurudhor ose rrugor) për aplikime mbi nënshtresat ose që bën tharjen, ose kujdeset pas këtyre aplikimeve, stampon me bojë ose ngjyros ose aplikon çdo material tjetër veshës si një veprimtari prodhimi		Ka gjasa që në çdo periudhë 12-mujore veprimtaria të përdorë: i. 20 tonë ose më shumë bojë stampimi, ngjyrosje ose material tjetër veshës që aplikohet në trajtë të ngurtë; ii. 20 tonë ose më shumë për çdo veshje metali që sprucohet në trajtë të shkrirë; iii. 25 tonë ose më shumë solucione organike për çdo lloj aktiviteti ofset në të ftohtë, ose veprimtari printimi ofset me fletë; ose

		ose gjatë veprimtarisë së prodhimit.		iv. 5 tonë ose më shumë për çdo veprimtari që nuk është përmendur në nënparagrafin (iii).
		f. Përveç rasteve të përmendura në tipin A të kësaj shtojce, prodhimi ose formulimi i bojës së stampimit ose të çdo materiali tjetër veshës që përmban ose përfshin përdorimin e solucioneve organike.		Të gjitha instalimet.
		g. Përveç rasteve të përmendura në tipin A të kësaj shtojce, prodhimi i pluhurit si material veshës.		Të gjitha instalimet.
Veprimtaritë e lëndës së drurit	7.10	a. Kujdesja ose tretja kimike e lëndëve të drurit, si pjesë e procesit të prodhimit, ose prodhime të përbëra tërësisht ose kryesisht nga druri.		Të gjitha instalimet.
		b. Përveç rasteve të përmendura në kategori të tjera të kësaj Shtojce, prodhimi i produkteve të përbëra tërësisht apo kryesisht nga druri n.q.s. veprimtaria përfshin: sharrimin, shpimin, fërkimin me rërë, gdhendjen, tornimin, zdrukthimin, kujdesin ose trajtimin kimik të drurit.		Ka gjasa që në çdo periudhë 12-mujore rezultati i veprimtarisë të jetë: i. 10 000 m^3 kur druri vetëm sharrohet; ii. 1 000 m^3 në çdo rast tjetër.
Veprimtaritë e gomës	7.11	a. Prodhimi i gomave të reja për makinat (por duke mos përfshirë riderdhjen dhe riveshjen).		Të gjitha instalimet.
		b. Përveç rasteve të përmendura në ndonjë nga veprimtaritë e tipit A, në këtë shtojcë, trazimi, bluarja ose përzierja e: i. gomës natyrale; ose ii. elastomereve me përbërje sintetike		Të gjitha instalimet.

		organike, n.q.s. është përdorur karboni i zi.		
		c. Riderdhja dhe riveshja e gomave.		Të gjitha instalimet.
Veprimtari të tjera që përfshijnë përdorimin e solventëve	7.12	a. Procesi i tharjes së shpejtë të bojës së stampimit/printimit me anë të ajrit të nxehtë.		Konsumi i solventëve është më i madh se 15 ton/vit.
		b. Publikim i materialeve me atë të procesit rotogravurë.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 25 ton/vit.
		c. Procese të tjera rotogravurë, flexografi, stampim/printim me makinë shtypi rotativë, laminim ose lustrim.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 15 ton/vit.
		d. Stampim/printim me makinë shtypi rotativë mbi tekstile/karton.		Të gjitha instalimet.
		e. Pastrim i sipërfaqes duke përdorur substanca ose preparate që për shkak të përbërjes së tyre të avullueshme, klasifikohen si kancerogjene, mutagjeneve ose toksike për riprodhimin.		Të gjitha instalimet.
		f. Pastrues të tjerë sipërfaqesh.		Të gjitha instalimet.
		g. Lyerja dhe lustrimi i makinave.		Të gjitha instalimet.
		h. Lyerja/veshja e bobinave.		Të gjitha instalimet.
		i. Veprimtari të tjera të lyerjes/veshjes përfshirë ato të metalit, plastikës, tekstileve (me përjashtim të stampimit/printimit me makinë shtypi rotativë të tekstileve), pëlhurave, filmit dhe letrës.		Të gjitha instalimet.
		j. Veshje e telave spirale.		Të gjitha instalimet.
		k. Përpunimi dhe saldimi i metaleve.		Me kapacitet të barabartë ose më shumë se 5 ton/ditë metal.
		l. Veprimtaritë e lyerjes/veshjes të		Të gjitha instalimet.

		aplikuara në sipërfaqe druri.		
		l. Pastrimi kimik.		Me kapacitet të barabartë apo më shumë se 1 ton/ditë tekstile.
		m. Procesi i njomjes së drurit.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 25 ton/vit.
		n. Veprimtaria e lyerjes/veshjes aplikuar në materiale lëkure.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 10 ton/vit.
		o. Prodhimi i këpucëve.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit.
		p. Laminimi i drurit dhe plastikës.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit
		q. Veshja me adeziv (material ngjitës).		Konsumimi i solventëve është më i madh se 5 ton/vit
		r. Prodhimi i preparateve veshëse, llaqeve, bojërave dhe ngjitësve.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 100 ton/vit
		s. Shndërrimi i gomës.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 15 ton/vit.
		t. Ekstraktimi i vajit vegjetal dhe yndyrës së kafshëve, si dhe veprimtaritë e rafinimit të vajit vegjetal.		Konsumimi i solventëve është më i madh se 10 ton/vit
Prodhimi i produkteve plastike	7.13	Përveç rasteve të përmendura në veprimtaritë e tipit A ose tipit B të kësaj shtojce, prodhimi i produkteve prej plastike.		me kapacitet të barabartë ose më të madh se 50 ton/vit.
Akuakulturë intensive	8.1	Rritje intensive e peshqve.		Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 1000 ton/vit ose më pak se kaq, por gjithsesi më i madh se 100 tonë peshk/vit.
	8.2	Rritje e guaskave të detit.		Kapaciteti i prodhimit është i barabartë me 1000 ton/vit ose më pak se kaq, por gjithsesi më i madh se 100 tonë guaska deti/vit.

Industritë prodhuese të komponentëve elektrik	9.1	Prodhim i kompjuterëve dhe produkteve elektronike dhe optike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
	9.2	Prodhim i pajisjeve elektrike n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
Industritë prodhuese të makinerive dhe pajisjeve	10.1	Prodhim i makinerive dhe pajisjeve n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
	10.2	Prodhim i mjeteve motorike, trailerave dhe gjysmë-trailerve n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
	10.3	Prodhim i mjeteve të tjera të transportit n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Të gjitha instalimet.
	10.4	Riparim dhe mirëmbajtje e makinerive dhe pajisjeve motorike dhe motoçikletave n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Kapaciteti është i barabartë me 5 ura ose më shumë se kaq.
Prodhimi i mobilieve	11.1	Prodhim i mobilieve, n.q.s. nuk janë përmendur diku tjetër në këtë shtojcë.		Kapaciteti i prodhimit më i madh se 1000 m^3 në vit.
Veprimtari të tjera	12.1	a. Kremimi i kufomave.		Të gjitha instalimet.
		b. Incinerimi i mbetjeve patologjike.		Të gjitha instalimet.
	12.2	Spitalet.		Të gjitha instalimet.
	12.3	Institucionet shëndetësore.		Çdo prodhues i mbetjeve spitalore i cili prodhon më shumë se 200 kg/vit mbetje spitalore të rrezikshme.
	12.4	Kapja e rrymave të CO2.	Nga të gjitha instalimet e kategorisë A që synojnë depozitimin gjeologjik.	

Shënime për tabelën e veprimtarive të tipit A

1. Për kategorinë 4, Industria Kimike, "prodhim" do të thotë prodhim në shkallë industriale me anë të përpunimit kimik të substancave ose grupeve të substancave të listuara në kategoritë nga 4.1 deri 4.6.

2. Kimikatet organike bazë përfshijnë, por nuk mjaftohen në:

a) hidrokarburet e thjeshta (linear apo ciklik, të ngopura ose të pangopura, alifatik ose aromatik);

b) hidrokarburet që përmbajnë oksigjen si alkoolet, aldehidet, ketonet, acidet karboksilike, esteret, acetatet, eteret, peroksidet, rezinat epokside;

c) hidrokarburet me bazë squfuri;

ç) hidrokarburet e hidrogjenuara si aminat, amidet, përbërjet nitroze, përbërjet nitrore, ose përbërjet nitrite, përbërjet nitrile, cianatet, izocianatet;

d) hidrokarburet me përmbajtje fosfori;

dh) hidrokarburet halogjenike;

e) përbërjet organometalike;

ë) materialet me bazë plastike (polimeret, fibrat sintetike dhe fibrat me bazë celuloze);

f) gomat sintetike;

g) bojërat dhe pigmentet;

gj) lëndët tensioaktive.

3. Kimikatet inorganike bazë përfshijnë, por nuk mjaftohen në:

a) gaze, si amonium, klori ose gazi kloridrik, floruret ose hidrogjen i floruruar, oksidet e karbonit, përbërjet e squfurit, oksidet e azotit, hidrogjeni, dioksid squfuri, kloruri i karbonilit;

b) acidet, si acidi kromik, acidi hidroflorik, acidi fosforik, acidi nitrik, acidi hidroklorik, acidi sulfurik, oleumi, acide sulfurore;

c) baza, si hidroksid amoni, hidroksid potasi, hidroksid natriumi;

ç) kripërat, si klorur amoni, klorat potasi, karbonat potasi, karbonat natriumi, perborate, nitrat argjendi;

d) jo metale, oksided e metaleve ose përbërje organike të tjera si karbit, silikon, karburi i silicit.

4. Rikuperimi i mbetjeve të rrezikshme nënkupton veprimtaritë rikuperuse të mëposhtme siç përcaktohet në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve:

R1. Përdorim kryesisht si karburant ose mjet të ndonjë lloji tjetër për gjenerim energjie.

R5. Riciklimi ose marrja e materialeve inorganike, përfshirë gazifikimin dhe pirolizen për t'i përdorur si kimikate.

R6. Rigjenerim i acideve ose bazave.

R8. Rikuperim i komponentëve nga katalizatorët.

R9. Rirafinimi i vajit ose ripërdorime të tjera të vajit.

5. Asgjësim i mbetjeve jo të rrezikshme nënkupton veprimtaritë asgjësuese të mëposhtme siç përcaktohen në legjislacionin për menaxhimin e mbetjeve:

D8.

D9.

6. Trajtim sipërfaqësor i substancave, objekteve ose produkteve përfshin, por nuk mjaftohet në:

a) përpunimin;

b) stampimin/printimin;

c) lyerjen/veshjen;

ç) zhvajosjen;

d) mbrojtjen nga uji;

dh) kalibrimin/përpunimin me saktësi sipas përmasave;

e) bojatisjen/ngjyrosjen;
ë) pastrimin;
f) regjien/ngopjen/njomjen në thellësi.

SHTOJCA 2
LISTA INDIKATIVE E SUBSTANCAVE KRYESORE NDOTËSE QË DUHEN MARRË PARASYSH NË QOFTË SE KANË RËNDËSI PËR CAKTIMIN E VLERAVE KUFI TË SHKARKIMEVE

Ajri

1. Dyoksid squfuri dhe komponime të tjera sulfurore.
2. Okside azoti dhe komponime të tjera azoti.
3. Monoksid karboni.
4. Përbërës organikë të avullueshëm.
5. Metale dhe përbërës të tyre.
6. Pluhuri.
7. Asbesti (grimca pezull, fibra).
8. Klori dhe përbërësit e tij.
9. Flori dhe përbërësit e tij.
10. Arseniku dhe përbërësit e tij.
11. Cianide.
12. Substanca dhe preparate që janë provuar të kenë veti kancerogjene ose mutagjene, apo veti që mund të cenojnë riprodhimin nëpërmjet ajrit.
13. Dibenzodioksinë e poliklorinuar dhe dibenzofuran i poliklorinuar.

Uji

1. Komponime dhe substanca organo-halogjene që mund të formojnë komponime të tilla në mjedisin ujor.
2. Komponime organo-fosforike.
3. Komponime organotin.
4. Substanca dhe preparate që janë provuar të kenë veti kancerogjene ose mutagjene, që mund të cenojnë riprodhimin në mjedisin ujor ose nëpërmjet tij.
5. Hidrokarburet e qëndrueshme dhe substancat e qëndrueshme dhe toksike organike të bioakumulueshme.
6. Cianide.
7. Metalet dhe komponimet e tyre.
8. Arseniku dhe komponimet e tij.
9. Biocidet dhe produktet për shëndetin e bimëve.
10. Materialet që rrinë pezull.
11. Substancat që kontribuojnë në eutrifikim (veçanërisht nitratet dhe fosfatet).
12. Substancat që kanë ndikim të pafavorshëm në balancën e oksigjenit (dhe që mund të maten duke përdorur parametra, si: BOD, COD etj.).

SHTOJCA 3
VLERAT KUFI TË SHKARKIMEVE PËR SO_2 – LËNDË DJEGËSE E NGURTË

Pjesa A

Vlerat kufi të shkarkimeve të SO_2 të shprehura në mg/Nm^3 (përmbajtja e O_2 është 6 për qind), që duhet të zbatohet nga impiantet ekzistuese në zbatim të nenit 21 (2):



Shënim. Kur vlerat kufi të shkarkimeve sa më sipër, nuk mund të arrihen për shkak të karakteristikave të lëndës djegëse, do të arrihet një përqindje desulfurizimi të paktën 60 për qind në rastin e impianteve me kapacitet termik nominal prej më pak ose të barabartë me 100 MWth, 75 për qind për impiante më të mëdha se 100 MWth dhe më pak se ose të barabarta me 300 MWth dhe 90 për qind për impiante më të mëdha se 300 MWth. Për impiantet më të mëdha se 500 MWth, do të aplikohet një përqindje desulfurizimi prej të paktën 94 për qind ose të paktën 92 për qind kur është lidhur një kontratë për përshtatjen e desulfurizimit të gazeve të furrës ose pajisjet e injektimit të gëlqeres, dhe puna në instalimin e saj ka filluar para datës 1 janar 2001.

Pjesa B

Vlerat kufi të shkarkimeve të SO_2 të shprehura në mg/Nm^3 (përmbajtja e O_2 është 6 për qind), që duhet të aplikohet nga impiantet e reja sipas nenit 21(1) me përjashtim të turbinave me gaz.

Tipi i lëndës djegëse	**50 - 100 MWth**	**100 - 300 MWth**	**>300 MWth**
Biomasë	200	200	200
Rast i përgjithshëm	850	200	200

Shënim. Kur vlerat kufi të shkarkimeve nuk mund të arrihen për shkak të karakteristikave të lëndës djegëse, instalimet do të arrijnë 300 mg/Nm^3 SO_2, ose do të arrihet një përqindje desulfurizimi prej të paktën 92 për qind në rast të impianteve me kapacitet termik nominal më pak ose të barabartë me 300 MWth dhe në rast të impianteve me kapacitet termik nominal më të madh se 300 MWth, do të aplikohet një përqindje desulfurizimi prej të paktën 95 për qind, së bashku me vlerën kufi maksimale

të shkarkimeve të lejueshme prej 400 mg/Nm^3.

SHTOJCA 4

VLERAT KUFI TË SHKARKIMEVE PËR SO_2 – LËNDË DJEGËSE TË LËNGSHME

Pjesa A

Vlerat kufi të shkarkimeve SO_2 të shprehura në mg/Nm^3 (përmbajtja e O_2 është 3 për qind) duhet të aplikohet nga impiantet ekzistuese, sipas nenit 21(2):



Pjesa B

Vlerat kufi të shkarkimeve SO_2 të shprehura në mg/Nm^3 (përmbajtja e O_2 3 për qind), duhet të zbatohen nga impiantet e reja sipas nenit 21(1), me përjashtim të turbinave me gaz

50 - 100 MWth	100 - 300 MWth	> 300 MWth
850	400 - 200 (rënie lineare)	200

SHTOJCA 5
VLERAT KUFI TË SHKARKIMEVE PËR SO_2 – LËNDËN DJEGËSE TË GAZTË

Pjesa A

Vlerat kufi të shkarkimeve SO_2 të shprehura në mg/Nm^3 (përmbajtja e O_2 është 3 për qind), duhet të aplikohen nga impiantet ekzistuese sipas nenit 21(2):

Tipi i lëndës djegëse	**Vlerat kufi (mg/Nm^3)**
Lëndë djegëse e gaztë në përgjithësi	35
Gazi i lëngët	5
Gazrat kalorifikë të ulët nga gazifikimi i mbetjeve të rafinerisë, gaz furre me koks, gaz furrnalte	800
Gazi nga gazifikimi i qymyrit	

Pjesa B

Vlerat kufi të shkarkimeve SO_2 të shprehura në mg/Nm^3 (përmbajtja e O_2 është 3 për qind), që duhet të zbatohen nga impiantet e reja sipas nenit 21(1):

Tipi i lëndës djegëse	**Vlerat kufi (mg/Nm^3)**
Lëndë djegëse e gaztë në përgjithësi	35
Gaz i lëngët	5
Gazra kalorifikë të ulët nga furra me koks	400
Gazra kalorifikë të ulët nga furrnalta	200

SHTOJCA 6
VLERAT KUFI TË SHKARKIMEVE PËR NO_X (E MATUR SI NO_2)

Pjesa A

Vlerat kufi të shkarkimeve NOx të shprehura në mg/Nm^3 (përmbajtja e O_2 është 6 për qind për lëndët djegëse të ngurta, 3 për qind për lëndët djegëse të lëngshme dhe lëndët djegëse të gazta), që duhet të zbatohen nga impiantet ekzistuese sipas nenit 21(2):

Tipi i lëndës djegëse	Vlerat kufi [(1)] (mg/Nm^3)
Lëndë djegëse e ngurtë ([1])([2]):	
50 - 500 MWth	600
> se 500 MWth	500
Nga 1 janari 2016	
50 - 500 MWth	600
> 500 MWth	200
Lëndë djegëse e lëngët	
50 - 500 MWth	450
> 500 MWth	400
Lëndë djegëse e gaztë	

50 - 500 MWth	300
> 500 MWth	200

Shënime:

1) Deri 31 dhjetor 2015, impiantet me kapacitet termik nominal më të madh se 500 MW, të cilat nga viti 2008 e në vazhdim nuk operojnë më shumë se 2 000 orë në vit (mesatarja e rrotullimit gjatë një periudhe prej pesë vjetësh), në qoftë se kanë marrë leje mjedisi në përputhje me nenin 21(2), i nënshtrohen një vlere kufi prej 600 mg/Nm³ për shkarkimet e oksidit të azotit (të matur si NO_2).

Nga 1 janari 2016, impiantet që nuk operojnë më shumë se 1500 orë në vit (mesatarja e rrotullimit gjatë një periudhe prej pesë vjetësh) i nënshtrohen një vlere kufi prej 450 mg/Nm³ për shkarkimet e oksidit të azotit (të matur si NO_2).

2) Deri më 1 janar 2018, impiantet që në periudhën 12-mujore që përfundon më 1 janar 2001, kanë operuar dhe vazhdojnë të operojnë me lëndë djegëse të ngurta, përmbajtja e avullueshme e të cilave është më pak se 10 për qind, do të zbatohet një vlerë kufi prej 1 200 mg/Nm³.

Pjesa B

Vlerat kufi të shkarkimeve të NOx të shprehura në mg/Nm³, që duhet të zbatohen nga impiantet e reja sipas nenit 21(1) me përjashtim të turbinave me gaz:

Lëndë djegëse e ngurtë (përmbajtja e O_2 është 6 për qind)

Tipi i lëndës djegëse	**50 - 100 MWth**	**100 - 300 MWth**	**> 300 MWth**
Biomasa	400	300	200
Rasti i përgjithshëm	400	200	200

Lëndë djegëse të lëngshme (përmbajtja e O_2 është 3 për qind)

50 - 100 MWth	100 - 300 MWth	> 300 MWth
400	200	200

Lëndë djegëse të gazta (përmbajtja e O_2 është 3 për qind)

Tipi i lëndës djegëse	**50 - 300 MWth**	**> 300 MWth**
Gaz natyror (shënimi 1)	150	100
Gazra të tjera	200	200

Shënime:

1) Gazi natyror është metani natyror me jo më shumë se 20 për qind (nga volumi) inerte dhe përbërës të tjerë.

Turbinat me gaz

Vlerat kufi të shkarkimeve NOx të shprehura në mg/Nm³ (përmbajtja e O_2 është 15 për qind), që duhet të zbatohen nga një njësi e vetme turbine me gaz sipas nenit 21(1) (vlerat kufi zbatohen vetëm për ngarkesë mbi 70 për qind).

Tipi i lëndës djegëse	**> 50 MWth (inputi termik në kushtet ISO)**

Gazi Natyror ([1])	50 ([2])
Lëndë djegëse të lëngshme ([3])	120
Lëndë djegëse të gazta (të ndryshme nga gazi natyror)	120

Turbinat me gaz për përdorim në raste emergjencash, të cilat operojnë më pak se 500 orë në vit, përjashtohen nga këto vlera kufi. Operatori i këtyre impianteve i paraqet çdo vit Agjencisë Kombëtare të Mjedisit një raport për kohën e përdorur.

Shënime:

1) Gazi natyror është metani natyror me jo më shumë se 20 për qind (nga volumi) inerte dhe përbërës të tjerë.

2) 75 /Nm^3 në rastet e mëposhtme ku efektiviteti i turbinës me gaz përcaktohet në kushtet bazë ISO për ngarkesën:

a) turbinat me gaz të përdorura në sisteme të kombinuara nxehtësie dhe energjie që kanë një efektivitet të përgjithshëm më të madh se 75 për qind;

b) turbinat me gaz të përdorura në impiantet me cikël të kombinuar, që kanë një efektivitet të përgjithshëm vjetor mesatar elektrik më të madh se 55 për qind;

c) turbinat me gaz për shtytjet mekanike.

Për turbinat me gaz me cikël të vetëm që nuk hyjnë në ndonjë prej kategorive të mësipërme, por që kanë një efektivitet më të madh se 35 për qind - të përcaktuara në kushtet bazë ISO të ngarkesës - vlera kufi e shkarkimeve do të jetë 50* η/35 ku η është efektiviteti i turbinës me gaz i shprehur si përqindje (dhe në kushte bazë ISO të ngarkesës).

3) Kjo vlerë kufi shkarkimesh aplikohet vetëm për turbinat me gaz që nxjerrin dritë dhe distilatet e mesme.

SHTOJCA 7
VLERAT KUFI TË SHKARKIMEVE PËR PLUHURIN

Pjesa A

Vlerat kufi të shkarkimeve të pluhurit, të shprehura në mg/Nm^3 (përmbajtja e O_2 është 6 për qind për lëndët djegëse të ngurta, 3 për qind për lëndët djegëse të lëngshme dhe lëndët djegëse të gazta) që duhet të zbatohen nga impiantet ekzistuese sipas nenit 21(2):

Tipi i lëndës djegëse	**Kapaciteti termik nominal (MW)**	**Vlerat kufi të shkarkimeve (mg/Nm^3)**
I ngurtë	≥ 500	50 ([2])
	< 500	100
I lëngshëm ([1])	Të gjitha impiantet	50
I gaztë	Të gjitha impiantet	5 si rregull
		10 për gazin e furrnaltës
		50 për gazrat e prodhuara nga industria e çelikut që mund të përdoret diku tjetër

Shënime:

1) Një vlerë kufi prej 100 mg/Nm^3 mund të zbatohet për impiantet me kapacitet termik nominal më pak se 500 MWth që djeg lëndë djegëse të lëngshme me përmbajtje hiri prej më shumë se 0,06 për qind.

2) Një vlerë kufi prej 100 mg/Nm^3 mund të zbatohet për impiantet që kanë marrë leje mjedisi sipas nenit 4(3) me kapacitet termik nominal më të madh ose të barabartë me 500 MWth që djeg lëndë djegëse të ngurtë me përmbajtje nxehtësie më pak se 5 800 kJ/kg (vlerë kalorifike neto), përmbajtje lagështie më të madhe se 45 për qind nga pesha, një lagështi të kombinuar dhe përmbajtje hiri më të madhe se 60 për qind nga pesha dhe një përmbajtje oksidi kalciumi më të lartë se 10 për qind.

Pjesa B

Vlerat kufi të emetimit të pluhurave të shprehura në mg/Nm^3, që duhet të zbatohen nga impiantet e reja, sipas nenit 21(1) me përjashtim të turbinave me gaz:

Lëndë djegëse të ngurtë (përmbajtja e O_2 është 6 për qind)

50 deri 100 MWth	>100 MWth
50	30

Lëndë djegëse të lëngshme (përmbajtja e O_2 është 3 për qind)

50 deri 100 MWth	>100 MWth
50	30

Lëndë djegëse të gazta (përmbajtja e O_2 është 3 për qind)

Si rregull	5
Për gazin e furrnaltës	10
Për gazrat e prodhuara nga industria e çelikut që mund të përdoren diku tjetër	30

SHTOJCA 8
METODA E CAKTIMIT TË VLERAVE KUFI TË SHKARKIMEVE PËR IMPIANTET ME NJËSI ME LËNDË DJEGËSE TË KOMBINUAR

1. Në rastin e impianteve me njësi me lëndë djegëse të kombinuar që lejon përdorimin njëkohësisht të dy apo më shumë lëndëve djegëse, Agjencia Kombëtare e Mjedisit vendos vlerat kufi të shkarkimeve si vijon:

a) Së pari, duke marrë vlerat kufi të shkarkimeve të secilës lëndë djegëse dhe secilin ndotës që i korrespondon inputit termik të impiantit me djegie, siç jepet në shtojcat 3 deri 7;

b) Së dyti, duke përcaktuar vlerat kufi të shkarkimeve sipas peshës së lëndës djegëse, që sigurohen duke shumëzuar vlerat kufi të çdo shkarkimi me inputin termik që çlirohet nga secila lëndë djegëse, dhe duke pjesëtuar këtë rezultat me shumën e inputeve termike të çliruara nga të gjitha lëndët djegëse;

c) Së treti, duke mbledhur vlerat kufi sipas peshës së lëndëve djegëse.

2. Në rastin e njësive me lëndë djegëse të kombinuar që përdorin mbetjet e distilimit dhe të shndërrimit nga rafinimi i naftës bruto për konsum vetjak, vetëm apo së bashku me lëndët djegëse të tjera, zbatohen kërkesat për lëndën djegëse me vlerën më të lartë kufi të shkarkimeve (lënda djegëse kryesore), pavarësisht paragrafit 1 më lart, në qoftë se gjatë funksionimit të impiantit me djegie pjesa

e kontribuar nga ajo lëndë djegëse në shumën e inputeve termike të çliruara nga të gjitha lëndët djegëse është të paktën 50 për qind.

Në rastin kur pjesa e lëndës djegëse kryesore është më pak se 50 për qind, vlera kufi e shkarkimit përcaktohet proporcionalisht me inputin e nxehtësisë së siguruar nga secila lëndë djegëse në raport me shumën e inputeve termike të çliruar nga të gjitha lëndët djegëse si më poshtë:

a) Së pari, duke marrë vlerën kufi të shkarkimit të çdo lënde djegëse dhe ndotësve që korrespondojnë me inputin e nxehtësisë së impiantit me djegie, siç jepet në shtojcat 3 deri 7;

b) Së dyti, duke llogaritur vlerat kufi të shkarkimeve të lëndës djegëse kryesore (lënda djegëse me vlerën kufi më të lartë sipas shtojcave 3 deri 7 dhe në rastin e dy lëndëve djegëse që kanë të njëjtën vlerë kufi të shkarkimeve, lënda djegëse me input termik më të lartë); kjo vlerë është rezultat i shumëzimit të vlerës kufi të shkarkimit që jepet në shtojcat 3 deri 7 për atë lëndë djegëse me një koeficient të barabartë me 2 dhe duke zbritur nga ky rezultat vlerën kufi të shkarkimit të lëndës djegëse me vlerën kufi të shkarkimit më të vogël;

c) Së treti, duke përcaktuar vlerat kufi të shkarkimeve sipas peshës së lëndës djegëse, që merren nga shumëzimi i vlerës kufi të shkarkimit me inputin termik të lëndës djegëse kryesore dhe vlerat e tjera kufi të shkarkimeve me inputin termik që çlirohet nga secila lëndë djegëse, dhe duke pjesëtuar rezultatin e shumëzimit me shumën e inputeve termike të çliruara nga të gjitha lëndët djegëse.

ç) Së katërti, duke agreguar vlerat kufi të shkarkimeve sipas peshës së lëndës djegëse.

3. Në rastin e impianteve me njësi me lëndë djegëse të kombinuar që lejojnë përdorimin e dy apo më shumë lëndëve djegëse, zbatohen vlerat kufi të shkarkimeve të dhëna në shtojcat 3 deri 7 që i korrespondojnë secilës lëndë djegëse.

SHTOJCA 9
METODAT E MATJES SË SHKARKIMEVE NGA IMPIANTET E MËDHA ME DJEGIE

1. Sipas paragrafit 2, kërkohet vetëmonitorim i vazhdueshëm për përqendrimet e SO_2, pluhurit dhe NOx nga mbetjet e gazta të çdo impianti me djegie që ka input termik prej 100 MW apo më shumë se kaq.

2. Me anë të derogimit nga nënparagrafi 1, Agjencia Kombëtare e Mjedisit mund të mos kërkojë matje të vazhdueshme në rastet e mëposhtme:

a) për impiantet me djegie me jetëgjatësi prej më pak se 10 000 orë operimi;

b) për SO_2 dhe pluhurin nga bojlerat që djegin gaz natyror ose nga turbinat me gaz që djegin gaz natyror;

c) për SO_2 nga turbinat me gaz ose mazut me përmbajtje të njohur squfuri në rastet kur nuk ka pajisje desulfurizimi;

ç) për SO_2 nga mazuti i biomasës në qoftë se operatori mund të provojë se shkarkimet e SO_2, në asnjë rrethanë nuk mund të jenë më të larta sesa vlerat kufi të shkarkimeve të parashikuara.

3. Kur nuk kërkohen matje të vazhdueshme, do të kërkohen matje sporadike të paktën çdo gjashtë muaj.

4. Si alternativë, për kërkesën në paragrafin 3, përdoren procedura të përshtatshme përcaktimi që verifikohen dhe miratohen nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, për të vlerësuar sasinë e SO_2, NOx dhe pluhurit të pranishëm në shkarkime. Këto procedura përdorin standarde CEN sapo ato të bëhen të disponueshme. Në qoftë se standardet CEN nuk janë të disponueshme, zbatohen standardet ISO, kombëtare ose ndërkombëtare, të cilat garantojnë sigurimin e të dhënave me cilësi shkencore të barasvlershme.

5. Operatori i impiantit me djegie informon Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për çdo

ndryshim të rëndësishëm në tipin e lëndës djegëse të përdorur apo në mënyrën e funksionimit të impiantit me djegie. Agjencia Kombëtare e Mjedisit, sipas informacionit të marrë, shqyrton nëse kërkesat e vetëmonitorimit për atë impiant me djegie janë të përshtatshme dhe nëse është e nevojshme, i ndryshon ato.

6. Matjet e vazhdueshme të kryera në pajtim me paragrafin 1 ose 2 përfshijnë procesin, parametrat e operimit të procesit përkatës të përmbajtjes së oksigjenit, temperaturës, presionit dhe përmbajtjes së avujve të ujit. Matja e vazhdueshme e përmbajtjes së avujve të ujit në gazrat e djegies nuk janë të nevojshme, me kusht që gazi i djegies, i marrë si kampion, të thahet para se të analizohen shkarkimet.

Matjet përfaqësuese, domethënë marrja dhe analiza e kampioneve të ndotësve përkatës dhe parametrave të procesit, si dhe metodat e referencës së matjeve për të kalibruar sistemet e automatizuara të matjeve kryhen në përputhje me standardet CEN sapo këto të bëhen të disponueshme. Në qoftë se standardet CEN nuk janë të disponueshme, zbatohen standardet ISO, kombëtare ose ndërkombëtare, që do të garantojnë sigurimin e të dhënave me cilësi shkencore të barasvlershme.

Sistemet e matjeve të vazhdueshme i nënshtrohen kontrollit me anë të matjeve paralele me metodat e referencës të paktën çdo vit.

1. Vlerat e intervaleve të sigurisë 95 për qind të një rezultati të vetëm të matur nuk tejkalojnë përqindjet e mëposhtme të vlerave kufi të shkarkimeve:

Dyoksidi i squfurit	20 për qind;
Oksidet e azotit	20 për qind;
Pluhuri	30 për qind.

Vlerat e validuara mesatare ditore dhe orare përcaktohen nga vlerat e matura mesatare orare të validuara pasi të jetë hequr vlera e intervalit të sigurisë të specifikuar më sipër.

Nuk do të konsiderohen ditët kur, për shkak të keqfunksionimit ose mirëmbajtjes së sistemit të vazhdueshëm të matjeve, nuk validohen më shumë se tri vlera mesatare orare. Në qoftë se gjatë një viti, për situata të tilla, zhvleftësohen më shumë se dhjetë ditë, Agjencia Kombëtare e Mjedisit i kërkon operatorit të marrë masa të mjaftueshme për të përmirësuar besueshmërinë e sistemit të vazhdueshëm të vetëmonitorimit.

SHTOJCA 10
PLANI I PËRPUTHSHMËRISË DHE AFATET

Në rastet kur, sipas nenit 53, operatorit të një instalimi ekzistues të tipit A ose B i kërkohet të dorëzojë në Agjencinë Kombëtare të Mjedisit një plan përputhshmërie me kërkesat bashkë me afatet e përmbushjes së tyre, ai duhet të sigurojë informacionin e mëposhtëm.

Tabela 1. Veprimtaritë për përmbushjen e kërkesave të lejes së mjedisit të tipit A ose B

Nr.	**Veprimtaria**	**Investimet (euro)**	**Fillimi i veprimtarisë (datë)**	**Përfundimi i veprimtarisë (datë)**	**Rezultate të veprimtarisë**	**Metoda e kontrollit**

Veprimtaritë: Përshkrim i veprimtarisë/veprimtarive që do të kryhen në mënyrë që instalimi të përmbushë kërkesat e legjislacionit mjedisor.

Investimet: Investimet për veprimtarinë (treguesin e mjeteve financiare të nevojshme për realizimin e çdo faze të planit operativ dhe treguesin e mjeteve të përgjithshme të nevojshme për realizimin e planit).

Fillimi: Data (muaji/viti) kur është planifikuar fillimi i veprimtarisë.

Përfundimi: Data (muaji/viti) kur është planifikuar përfundimi i veprimtarisë.

Rezultatet e veprimtarisë: Do të përshkruhen rezultatet specifike (p.sh.: reduktimi i shkarkimeve, vlerat e emisioneve për kohën e realizimit të fazave të veçanta të planit.

Metoda e kontrollit: Përshkrim i mënyrës që do të përdoret për të bërë të mundur kontrollin e veprimtarisë (monitorimin dhe mënyrën e informimit etj.).

Tabela 2. Afatet kohore për zbatimin e veprimtarive në tabelën 1 dhe investimet vjetore

	Veprimtaritë	**Kostot vjetore - euro**				
		Viti*	Viti*	Viti*	Viti*	Viti*

* Analizat kosto - përfitim të operatorit, përfshirë shpenzimin vjetor të nevojshëm për zbatimin e secilës veprimtari të tabelës 2.